



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 123

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 22 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 64/2024, datë 27.6.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri.....
	14523
Dekret i Presidentit nr. 248, datë 11.7.2024	Për shpallje ligji.....
	14545
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 10.7.2024	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme për organet e vetëqeverisjes vendore, në Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024.....
	14545
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 17.7.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 1179, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave”.....
	14545
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 17.7.2024	Për kalimin të Bashkia Tiranë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat)
	14546
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 17.7.2024	Për kalimin në pronësi të Bashkia Tiranë të objektit “Godinë e shërbimeve komunitare, Vaqarr”
	14548
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 17.7.2024	Për përcaktimin e sasisë në përqindje të sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t’u rinovuar çdo vit, kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike.....
	14548
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 17.7.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Elbasan 1 – Cërrik”
	14554

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 17.7.2024	Për pezullimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës, për përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme.....	14557
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 17.7.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit ‘Për akcizat’”, të ndryshuar.....	14557
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 17.7.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 192, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e projektit pilot ‘Për zbatimin e mënyrave alternative të pagesës së shpejtë’ dhe të procedurave për zbatimin e tij”	14558
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 17.7.2024	Për lirin nga detyra të prefektit të qarkut të Vlorës.....	14559
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 17.7.2024	Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit, si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratës së sipërmarrjes/porosisë dhe të premtimshitjes.....	14559
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 13.6.2024	Lulzim Caka kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 31948/13</i>)	14562
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 819/9, datë 17.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës – Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”	14566



LIGJ
Nr. 64/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRQEVERITARE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
FRANCËS PËR KONTRIBUTIN NË
ZBATIMIN E PROJEKTEVE
PRIORITARE NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.6.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 248, datë 11.7.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj**

**MARRËVESHJE NDËRQEVERITARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE
MBI KONTRIBUTIN NË ZBATIMIN E
PROJEKTEVE PRIORITARE NË SHQIPËRI**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Franceze (në vijim referuar si “Palët”);

me synimin për të forcuar lidhjet e miqësisë dhe bashkëpunimit që i lidh, si dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik të Republikës së Shqipërisë;

me dëshirën për të zhvilluar një kornizë të re për bashkëpunim strategjik për të nxitur zhvillimin e tregtisë dhe ekonomisë;

me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve për të përballuar sfidat ekonomike, demografike, sociale, shoqërore dhe mjedisore;

me dëshirën për të ndarë njohuritë dhe teknologjitë, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, veçanërisht, në aspektin e shërbimeve mjedisore, sigurisë dhe lëvizshmërisë;

me dëshirën për të punuar së bashku për të kontribuar në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;

duke pasur në vëmendje “Udhërrëfyesin për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Franceze”, të nënshkruar në Tiranë, më 17 tetor 2023;

duke pasur parasysh “Traktatin e mirëkuptimit, miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Franceze”, nënshkruar më 12 dhjetor 1994;

duke theksuar rëndësinë e luftës kundër korrupsionit në transaksionet tregtare ndërkombëtare, në respektim të standardeve të përcaktuara nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD/OBZHE);

duke inkurajuar respektimin e normave mjedisore dhe sociale të njohura nga komuniteti ndërkombëtar, përfshirë konventat ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP/ILO), konventat ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe mjedisin, dhe standardet e performancës së Korporatës Ndërkombëtare Financiare;

duke vepruar në bazë të barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objektivat e marrëveshjes

Palët do të ndërmarrin veprime bashkëpunimi me qëllim identifikimin dhe zbatimin e projekteve strategjike prioritare në Republikën e Shqipërisë, në fushat e turizmit, menaxhimit të ujit, mjedisit, inovacionit, digjitalizimit, energjisë, reformës së



administratës publike, transportit, arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë. Palët do t'i zhvillojnë këto projekte prioritare strategjike, në mënyrë të tillë që të lehtësojnë transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin profesional të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të pakualifikuar, ndërsa përpiqen të kontribuojnë në përgatitjen e Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Për këtë qëllim, palët do të ndajnë informacionin përkatës për këto projekte dhe do të identifikojnë financimin për të mbështetur zbatimin e tyre, në përputhje me standardet e financimit të qëndrueshëm, veçanërisht Parimet e Kombeve të Bashkuara për investime të përgjegjshme dhe parimet e G20-s për investimet në infrastrukturë me cilësi të lartë.

Neni 2

Mënyrat prioritare të bashkëpunimit

Palët punojnë së bashku për të zbatuar projekte në Republikën e Shqipërisë, të cilat aktualisht janë:

- Kontributi në modernizimin infrastrukturës dhe menaxhimin e shërbimeve komunale, menaxhimit të ujit, trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve, në Tiranë dhe Durrës, për të arritur standardet e BE-së;

- Zhvillimi i ekosistemit të inovacionit dhe forcimi i infrastrukturës së qeverisjes elektronike, përfshirë sigurinë dhe qëndrueshmërinë kibernetike;

- Modernizimi i sektorit të energjisë për të favorizuar përmirësimin e rrjetit të energjisë – prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja – si dhe energjinë e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë, dhe zhvillimin e mundshëm të burimeve të reja të energjisë;

- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, me fokus të veçantë në qarkun e Korçës, veçanërisht në turizmin malor;

- Çështjet e menaxhimit të ujit që lidhen me ujitjen dhe parandalimin e përmbytjeve;

- Optimizimi i Burimeve Njerëzore me fokus modernizimin e sektorit publik;

- Nxitja e bashkëpunimit në fushën e arsimit parauniversitar, përfshi arsimin dhe formimin profesional (VET/AFP), arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

- Nxitja për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar franceze në Republikën e Shqipërisë, institucioneve franceze të

arsimit të lartë ose të degëve të tyre, modalitetet e organizimit dhe veprimtarisë e të cilave do të përcaktohen në aktet përkatëse të hapjes, ku sipas rastit do të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë hapjen e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet përkatëse të arsimit të lartë të të dyja vendeve.

Projektet në fusha të tjera të identifikuara në Udhërrëfyesin Ekonomik dhe Traktatin e Mirëkuptimit, Miqësisë dhe Bashkëpunimit, të përmendur në preambulë, veçanërisht në fushat e bujqësisë, energjisë dhe infrastrukturave të tjera, do të zhvillohen së bashku.

Gjithashtu, në kuadër të reformës së administratës publike të Shqipërisë dhe agjendës së saj më të gjerë të Integritetit Evropian, palët angazhohen të lehtësojnë shkëmbimet e njohurive, sfidave aktuale dhe qasjeve inovatore në fushën e politikave të administratës publike me fokus në avancimin e vazhdueshëm të profesionalizimit, transformimit dhe modernizimit të sektorit publik.

Një komitet i përbashkët do të identifikojë mundësitë për projekte të reja dhe do të vlerësojë progresin në këto fusha, si dhe zbatimin e projekteve të sipërpërmendura, dhe do t'u raportojë palëve, siç parashikohet në aneksin 1, pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Në sektorin e inovacionit, një Këshill i Inovacionit Francë-Shqipëri do t'u propozojë palëve veprime për të avancuar në drejtim të objektivave të përmendur në këtë marrëveshje dhe në udhërrëfyes, siç parashikohet në aneksin 2, pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje do të propozohen dhe zhvillohen nga autoritetet përkatëse, dhe kur është e nevojshme nga subjektet private përkatëse, përmes marrëveshjeve, kontratave, programeve ose projekteve specifike. Palët bien dakord që kompanitë franceze dhe shqiptare të marrin pjesë në zbatimin e projekteve, sipas proceseve të rena dakord ndërmjet palëve.

Përmendja e projekteve të Grupit të Agjencisë Franceze të Zhvillimit në këtë marrëveshje është tregues. Këto projekte të veçanta do të ndjekin përgatitjen dhe përpunimin, si dhe procedurat e zbatimit dhe udhëzimet specifike të grupit.

Zbatimi i projekteve ekzistuese dhe të ardhshme, sipas kësaj marrëveshjeje, mund të jetë në formën e:



- Studimeve të parafizibilitetit dhe fizibilitetit për identifikimin e projekteve të reja, si dhe zbatimin e projekteve të përmendura në këtë marrëveshje;

- Punë civile dhe ndërtimi, dhe shërbime konsulence për menaxhimin e projekteve, mbikëqyrjen dhe përgatitjen e funksionimit dhe mirëmbajtjes;

- Blerjen e makinerive, pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për realizimin dhe mirëmbajtjen e projekteve në fjalë;

- Asistencë teknike për të mbështetur zbatimin e projektit, ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin institucional, qoftë me vendosjen e ekspertëve teknikë ose nëpërmjet programeve *ad hoc* të bashkëpunimit teknik;

- Format e tjera të bashkëpunimit të dakordësuara ndërmjet palëve.

Neni 3

Mbështetja financiare

Qeveria e Republikës Franceze konfirmon interesin e saj për të mbështetur projektet strategjike prioritare në Republikën e Shqipërisë dhe për të shqyrtuar përdorimin e instrumenteve të saj të financimit. Grupi AFD/AFZH është, gjithashtu, i gatshëm të vërë në dispozicion një ofertë financimi për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, për projekte që integrojnë tranzicionet drejt trajektoreve të zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për Klimën dhe konvergencën e BE-së.

Burimet e financimit në dispozicion të palës franceze përfshijnë, por nuk kufizohen në, këto të renditura më poshtë:

- grantet nga Fondi i Studimeve dhe Asistencës në Sektorin Privat (në vijim referuar si “Grante FASEP/FSASP”), që përdoren nga kompanitë franceze për të kryer studime fizibiliteti dhe projekte pilot për organet publike shqiptare;

- huat direkte nga Thesari janë huat sovraane të përcaktuara nga rregullat e Marrëveshjes së OECD/OBZHE-së (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) për Kreditë e Eksportit të Mbështetura Zyrtarisht (në vijim referuar si “Marrëveshja e OECD/OBZHE-së”), që financojnë zbatimin e projekteve strategjike prioritare të kryera nga kompanitë franceze për përfitimin e subjekteve publike në shtetet e huaja;

- sigurimi i kredisë së blerësit, e menaxhuar nga agjencia e eksportit të kreditit *Bpifrance Assurance Export*, që vepron në emër dhe për llogari të shtetit të Francës, mund të jepet rast pas rasti për të mbështetur projekte prioritare strategjike, të pranueshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me strategjinë e garantimit të kredisë së eksportit të Francës dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, Marrëveshjen e OECD/OBZHE-së;

- hua sovraane, hua josovraane, fondet e asistencës teknike për mobilizimin e ekspertëve ndërkombëtarë, grantet dhe garancitë e dhëna nga anëtarët e Grupit AFD/AFZH.

Grantet FASEP, huat direkte ose koncesionare nga Thesari Francez dhe garancitë publike i nënshtrohen miratimit nga një komitet ndërmintor francez, në përputhje me politikat e brendshme të Thesarit Francez dhe rregullat në fuqi të OECD/OBZHE-së.

Financimi i Grupit AFD duhet të miratohet nga organet vendimmarrëse të Grupit AFD/AFZH (përfshirë filialet), të cilat vendosin në bazë të interesit zhvillimor të projektit dhe konsideratave, veçanërisht financiare, të vetë Grupit.

Republika e Shqipërisë mund të zgjedhë edhe një formë tjetër financimi për projektet prioritare të përmendura, në varësi të kushteve financiare dhe kapaciteteve buxhetore të qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Mobilizimi i fondeve

Mobilizimi i një granti FASEP duhet të çojë në nënshkrimin e një memorandumit mirëkuptimi midis ofruesit francez të shërbimit dhe përfituesit shqiptar.

Nëse palët bien dakord për mobilizimin e huave direkte ose koncesionare nga Thesari Francez, ose kredi bankare të garantuara nga *Bpifrance Assurance Export* që vepron në emër dhe për llogari të shtetit francez, do të nënshkruhen dhe do të ratifikohet marrëveshje të veçanta.

Mobilizimi i një kredie direkte nga Thesari kërkon nënshkrimin e një protokolli financiar ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Franceze. Më pas, duhet të nënshkruhet një marrëveshje financimi ndërmjet *BPI France*, që vepron në emër dhe për llogari të



qeverisë së Republikës Franceze, dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Mobilizimi i kredive bankare të garantuara nga *Bpifrance Assurance Export* kërkon nënshkrimin e një marrëveshjeje kredie ndërmjet institucioneve bankare dhe huamarrësit. Kjo marrëveshje duhet të përcaktojë termat dhe kushtet për përdorimin e kredive bankare të garantuara, si dhe kushtet përkatëse të kredisë, duke përfshirë kushtet për financimin e primit të riskut, në përputhje me rregullat e marrëveshjes së OECD/OBZHE-së.

Burimet e financimit të Grupit AFD/AFZH mobilizohen përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të veçanta të financimit në varësi të burimit të financimit në fjalë.

Vendosja e ekspertëve teknikë ndërkombëtarë kërkon një shprehje interesi nga administrata pritëse drejtuar Ministrisë Franceze të Financave. *Expertise France* (agjencia e bashkëpunimit teknik të Grupit AFD/AFZH) do të jetë përgjegjëse për mobilizimin e ekspertizës në Shqipëri.

Shumat e alokuara për projektet e përmendura në nenet 6 deri në 9, janë indikative dhe kushtet e financimit të tyre do të specifikohen në protokollin financiar, marrëveshjet e kredisë dhe marrëveshjet e financimit të nënshkruara për çdo projekt.

Neni 5

Termat dhe kushtet e kontratave tregtare

Zbatimi dhe përfundimi i projekteve të parashikuara në këtë marrëveshje do të rregullohet nga marrëveshje specifike në lidhje me eksportet, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve ose ndërtimin, të përgatitura nga autoritetet kompetente dhe institucionet, dhe kompanitë e palëve, me miratimin e autoriteteve publike të të dyja vendeve dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve (në vijim referuar si “kontrata tregtare”).

Kjo marrëveshje përcakton se rregullat dhe procedurat për kontratat e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, janë si më poshtë:

- Për kontratat dhe operacionet e financuara nga huat direkte, do të zbatohen rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e furnitorëve, të parashikuara nga kuadri ligjor francez;

- Për kontratat e financuara nga grantet FASEP, qeveria e Republikës Franceze do t’u sigurojë autoriteteve kompetente shqiptare furnitorët e kualifikuar dhe të përzgjedhur që do të realizojnë

projektin. Modalitetet për përzgjedhjen e fituesit të projektit do të përcaktohen me marrëveshje të veçanta financiare;

- Për operacionet e financuara ose të zbatuara nga Grupi AFD/AFZH, modalitetet për kontratat do të rregullohen nga udhëzimet e prokurimit të zbatueshme për Grupin e AFD/AFZH ose palë të tjera të interesuara në rast të bashkëfinancimit.

Mbështetja financiare për zbatimin e kontratave në fjalë do të sigurohet nga instrumentet financuese të përmendura në nenin 3, të kësaj marrëveshjeje ose nga një instrument tjetër financimi i pranueshëm për Republikën e Shqipërisë.

Vlera e të gjitha kontratave në fjalë, të financuara nga ndihma financiare, shprehet në euro, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve.

Neni 6

Kontributi financiar për projektet e ujit

Partneriteti strategjik midis Shqipërisë dhe Francës për shërbimet publike do të përfitojë nga përvoja e projektit prioritar për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit të Tiranës, në lidhje me kontratën e qirasë për të cilën do të përgatitet një proces tenderimi.

Kontributi financiar i mobilizuar për këtë projekt është si më poshtë:

- një grant për asistencën teknike të përdorur për përgatitjen e tenderit për kontratën e qirasë;

- një kredi direkte nga Thesari Francez për një shumë maksimale prej 90 milionë eurosh për modernizimin e rrjetit të ujit të qytetit (“minizona”).

Grupi AFD është përzgjedhur si IFN (Institucioni Financiar Ndërkombëtar), kryesues për përgatitjen dhe financimin e projekteve të mëposhtme:

- rikonstrukcioni i rrjetit të ujërave të zeza në qendrën historike të Durrësit (projekti WB25-ALB-ENV, CIBO 2024);

- rehabilitimi i rrjeteve të kanalizimeve në zonat e banuara në Durrës (Spitallë dhe Porto-Romano).

Neni 7

Kontributi financiar për projektet që kontribuojnë në inovacion dhe digjitalizim

Financimi do të sigurohet për projektet e mëposhtme:

- asistencë teknike për zhvillimin e një qendre të vazhdimësisë së biznesit për operacionet e *e-gov* dhe një hua potenciale thesari për realizimin e projektit;
- asistencë teknike për studimin e mjedisit për investime në sektorin digjital.

Neni 8

Kontributet financiare për projekte në sektorin e turizmit

Financimi do të sigurohet për projektet e mëposhtme:

- një studim për hartimin e një masterplani për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit për qarkun e Korçës;
- në lidhje me projekte bashkëpunimi ndërmjet organeve arsimore të financuara nga shteti, asistencë teknike për studimin e kushteve për zhvillimin e formimit profesional të ofruar nga operatorët francezë në sektorin e turizmit.

Neni 9

Kontribute financiare për projekte në bujqësi

Financimi do të sigurohet për projektet e mëposhtme:

- studim fizibiliteti, hartimi i projekteve të detajuara dhe rikonstruksioni/modernizimi i infrastrukturës fizike së ujitjes me ngritje mekanike të ujit (me stacione pompimi të ujitjes), kryesisht në zonën bregdetare perëndimore.

Grupi AFD do të përpaket t'u përgjigjet kërkesave të shprehura nga autoritetet shqiptare në sektorët prioritarë, të përmendur në nenet 6 deri në 9, duke i dhënë përparësi financimit të projekteve konkrete që janë sa më pranë nevojave të qytetarëve dhe bizneseve.

Neni 10

Regjistrimi i protokolleve financiare dhe kontratave tregtare

Regjistrimi në protokollin aktual të protokolleve financiare që kornizojnë dispozitat e financimit, të përmendura në nenet 6 deri në 9, dhe çdo kontratë të përmendur në nenin 5 të kësaj marrëveshjeje, do t'i nënshtrohet:

- i. përputhshmërisë së kontratës me rekomandimet e formuluar nga paravlerësimi i

projektit që korrespondon me kontratën në fjalë, si dhe përmbajtjen e tij duke përfshirë shërbimet e ofruara dhe çmimet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Franceze, përveç operacioneve të Grupit të AFD/AFZH;

- ii. përputhshmërisë së projektit me dispozitat e marrëveshjes së OECD/OBZHE-së për kreditë e eksportit që përfitojnë nga mbështetja publike, përveç operacioneve të Grupit të AFD/AFZH;

- iii. shumat e detyrimeve dhe të pagueshme nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për qeverinë e Republikës Franceze;

- iv. shumat e detyrimeve dhe të pagueshme nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Agjencinë Franceze të Zhvillimit (AFD/AFZH);

- v. shumat e detyrimeve dhe të pagueshme sipas kredive bankare të garantuara nga Republika Franceze;

- vi. pajtueshmërinë me angazhimet e përfshira në nenet 12 dhe 13 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11

Afatet e mbështetjes financiare

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare në formën e huave të Thesarit Francez, datat e imputimit të të gjitha kontratave të nënshkruara ndërmjet furnitorëve francezë dhe blerësve shqiptarë duhet të specifikohen në çdo protokoll financiar, për çdo projekt.

Këto data nuk mund të shtyhen, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, dhe vetëm pas një marrëveshjeje të ndërsjellë, me shkëmbim letrash, ndërmjet palëve.

Neni 12

Angazhimet për luftën kundër korrupsionit

Palët kanë rikujtuar në preambulë angazhimin e tyre për luftën kundër korrupsionit në transaksionet tregtare ndërkombëtare.

Palët, në kontratat e regjistruara sipas kësaj marrëveshjeje, as nuk do t'i ofrojnë, as nuk do t'i japin një pale të tretë, as nuk do të kërkojnë, pranojnë ose premtojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi, për veten e tyre ose për një palë tjetër, ndonjë përfitim të panevojshëm monetar ose ndonjë përfitim tjetër, i cili do ose mund të jetë një praktikë e paligjshme dhe korruptive.



Palët marrin përsipër të sigurojnë që projekti të mos rezultojë në praktikë korrupsioni. Palët angazhohen të informojnë njëra-tjetrën sapo të kenë dijeni për informacionin që rezulton në dyshim dhe të veprojnë në mënyrë të përshtatshme për të adresuar situatën, përpara një afati të caktuar dhe të kënaqshëm.

Në rast të mosrespektimit të këtyre angazhimeve, qeveria e Republikës Franceze rezervon të drejtën të refuzojë regjistrimin e një kontrate dhe/ose të pezullojë disbursimin e mbështetjes financiare dhënë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Angazhimet ndaj përgjegjësisë sociale dhe mjedisit

Për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, palët bien dakord se është e nevojshme të inkurajohet përputhshmëria me standardet sociale dhe mjedisore të njohura nga komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë konventat ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO/ONP) dhe Kombeve të Bashkuara, në lidhje me ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe mjedisin.

Neni 14

Postvlerësimi i projektit

Qeveria e Republikës Franceze mund të vazhdojë me shpenzimet e saj për të ndërmarrë postvlerësimin e projektit në nivele ekonomike, financiare dhe kontabël, me qëllim vlerësimin e ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë mund të marrë pjesë në këtë vlerësim, sipas kushteve që do të përcaktohen, për të përfituar drejtpërdrejt nga gjetjet. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë merr përsipër të presë misionin e postvlerësimit të dërguar nga qeveria e Republikës Franceze dhe të lehtësojë aksesin e tij në informacion në lidhje me projektin.

Projektet e financuara nga Grupi AFD vlerësohen sipas procedurave specifike të tij, në përputhje me kushtet e marrëveshjeve të financimit. Këto vlerësime do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet rrugëve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 16

Identifikimi i projekteve shtesë

Projektet strategjike shtesë, të identifikuar në një datë më të mëvonshme se nënshkrimi i marrëveshjes, që mund të përfitojnë nga ndihma financiare e Qeverisë së Republikës Franceze, mund të përfshihen në marrëveshje përmes shkëmbimit të letrave të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 17

Amendamentet e marrëveshjes, duke përfshirë ndryshimet e shumave të mbështetjes financiare

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje reciproke me shkrim ndërmjet palëve. Shumat e mbështetjes financiare mund të ndryshohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim. Ndryshime të tilla janë pjesë përbërëse e marrëveshjes dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 15 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore me konsultim ose negociim ndërmjet palëve.

Neni 19

Përfundimi

Secila palë mund të ndërpresë bashkëpunimin sipas kësaj marrëveshjeje në çdo kohë. Pala që dëshiron të ndërpresë bashkëpunimin, sipas kësaj marrëveshjeje, njofton palën tjetër për qëllimin e saj me shkrim. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje hyn në



fuqi gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të ndikojë në projektet dhe programet e përbashkëta të nisura përpara përfundimit të saj.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e të dyja palëve, të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në Paris, më 12 prill 2024, në dy origjinale, në gjuhën shqipe dhe frënge, të dyja tekstet janë autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Blendi Gonxhja
**Ministër i Ekonomisë, Kulturës
dhe Inovacionit**

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
FRANCEZE
Jean-Noël Barrot
Zv.ministër i ngarkuar për Evropën

ANEKS 1 KOMITETI I PËRBASHKËT I MONITORIMIT

Në lidhje me nenin 2, është vendosur ngritja e një komiteti të përbashkët për të monitoruar zbatimin e marrëveshjes.

1. Përbërja

Komiteti i përbashkët i monitorimit përbëhet nga:

- *Nga ana shqiptare:*
- Drejtori i Kabinetit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Këshilltari Diplomatik i Kryeministrit.
- *Nga ana franceze:*
- Ambasadori i Francës në Shqipëri;
- Këshilltari Ekonomik Rajonal i Francës, përkatës për Shqipërinë.

2. Modalitetet

Komiteti i përbashkët i monitorimit do të mbajë një takim tremujor, në një vend dhe format të dakordësuar nga Palët dhe do t'u raportojë autoriteteve të tyre përkatëse.

Secila Palë cakton një person për të mbajtur shënime dhe hartuar raportin (në gjuhën angleze).

Komiteti i përbashkët i monitorimit ka të drejtë të ftojë ekspertë dhe/ose palë të interesuara për të marrë pjesë në takime sipas rendit të ditës.

Këshilli Shqiptaro-Francez i Inovacionit (aneksi 2) i raporton komitetit të përbashkët të monitorimit sipas rendit të ditës.

Të paktën një herë në vit pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, komiteti i përbashkët i monitorimit do të hartojë një raport gjithëpërfshirës (në gjuhën frënge dhe shqipe) mbi zbatimin e marrëveshjes, sipas nenit 2.

ANEKS 2 KËSHILLI I INOVACIONIT SHQIPËRI– FRANCË–FAIC

Referuar nenit 2, të marrëveshjes krijohet një Këshill i Inovacionit Shqipëri–Francë–Faic, si më poshtë:

1. Objektivi i përgjithshëm

FAIC-u mbledh së bashku zyrtarë qeveritarë dhe aktorë të jashtëm nga fusha të ndryshme të inovacionit për të sjellë ide dhe këshilla për të lehtësuar zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe ekosistemit të inovacionit, në dobi të aktorëve në Shqipëri dhe në Francë.

Duke iu referuar udhërrëfyesit ekonomik të nënshkruar më 2023-n dhe kësaj marrëveshjeje, Këshilli i FAIC-ut do të përpiqet të kontribuojë në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, veçanërisht, në fushat e mëposhtme:

- transferimi i njohurive nga strukturat franceze të inovacionit, private dhe publike;
- bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve/agjencive;
- nevojat për financimin e infrastrukturës digjitale;
- strategjia e zhvillimit për sektorin digjital në Shqipëri.

Në bashkëpunim me organizatat franceze dhe shqiptare, FAIC-u mund të propozojë fusha të tjera bashkëpunimi për inovacionin.

2. Udhëzime operative

FAIC-u miraton një qasje bashkëpunuese ku të gjithë dëgjohen.

Puna e FAIC-ut bazohet në udhërrëfyesin ekonomik Shqipëri–Francë, i cili përditësohet çdo vit nga qeveritë sipas prioritetëve të bashkëpunimit Shqipëri–Francë në fushën e inovacionit.



Menaxhon prioritetet dhe raporton te të dyja qeveritë në intervale të rregullta jo më pak se 2 herë në vit.

Përcakton dhe ndjek KPI-të e progresit dhe i miraton ato nga të dyja qeveritë.

FAIC-u mbledhet të paktën çdo tremujor.

Takimet mund të organizohen nëpërmjet video-konferencave, po të paktën një herë në vit personalisht.

Punimet do të organizohen me mbështetjen e Ambasadës Franceze në Shqipëri, Ambasadës Shqiptare në Francë dhe të Zyrës Ekonomike Rajonale të Ballkanit Perëndimor.

Komiteti mund të vendosë rregulla për funksionimin e brendshëm, për shembull: anëtarët të kenë një “mendësi konstruktive” – duke u fokusuar në mundësitë dhe jo në kufizimet.

FAIC-u mund të përcaktojë disa norma gjatë takimit të parë për të pasur mjete të përbashkëta pune, si metoda “agile”, këshilla për të ndihmuar anëtarët të formulojnë pyetjet etj.

3. Propozimet për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Inovacionit:

Përcakton një numër tek anëtarësh, për të cilët duhet të ketë dakordësim midis Palëve, personaliteteve nga sektori publik dhe privat, veçanërisht nga diaspora shqiptare në sektorin e teknologjisë dhe inovacionit.

Zgjidhni njerëz që zotërojnë grupe të ndryshme aftësish dhe përvojash.

Anëtarët emërohen për 2 vjet, pas një procesi përzgjedhjeje përmes paraidentifikimit dhe intervistave.

Anëtarët e FAIC-ut angazhohen të ofrojnë një sasi pune në krye të takimeve të FAIC-ut. Përzgjedhja e tyre mund të bëhet në mesin e:

- Personaliteteve të diasporës shqiptare në Francë, që mund të përbëjnë një urë lidhëse me institucionet dhe kompanitë franceze;

- përgjegjësve të sektorit privat në fushën e teknologjisë, të botës digjitale dhe të financimit fillestar;

- specialistëve të inovacionit në arsim, universiteteve;

- investitorëve francezë në sektorin digjital në Shqipëri, *French Tech*: BPI Francë; grupi AFD.

- Personaliteteve në Shqipëri:

- nga administrata publike (për shembull: sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për inovacionin);

- nga sektori privat me përvojë të gjerë në fushën digjitale dhe të inovacionit;

- nga institucionet financiare;

- nga arsimi.

4. Komunikimi mbi rolin e FAIC-ut për të gjitha organizatat e interesuara:

Roli dhe aktivitetet e FAIC-ut i duhen komunikuar në mënyrë të qartë dhe koherente palëve të interesuara. Kjo siguron që individët të cilët angazhohen me Këshillin, si dhe funksionet e tjera qeverisëse të qeverive, të kenë pritshmëri të qarta dhe të mund të menaxhojnë në përputhje me rrethanat ndërveprimet e tyre me Këshillin.

5. Matja e suksesit:

Ndjekja e progresit të Këshillit të Inovacionit Shqipëri–Francë duke përdorur treguesit kryesorë të performancës (KPI).

Programi fillestar i punës

FAIC-u duhet të bazohet në projektet ekzistuese të përfshira në marrëveshjen ndërqeveritare dhe objektivat e përcaktuar në udhërrëfyesin ekonomik të vitit 2023.

Pyetjet që do të trajtohen, janë:

- Nevojat për infrastrukturën digjitale: a mund të ndihmojnë kompanitë franceze?

- Si mund të përmirësohet organizimi institucional (duke iu referuar diskutimeve me BPI Francë)?

- Si mund ta ndihmojë *French Tech* që Shqipëria të bëhet një qendër rajonale inovacioni?

- Projektet e bashkëpunimit: *open data* dhe autoritetet lokale; platforma Euroquity; Ecole 42; Station F ose një strukturë ekuivalente.

- Investimi në shërbimet digjitale: A është gati Shqipëria, a mund të përmirësohet mjedisi?

- Inteligjenca artificiale, shërbimet digjitale dhe politika aktive e punësimit.



ACCORD

ENTRE

LE CONSEIL DES MINISTRES DE LA RÉPUBLIQUE D'ALBANIE

ET

LE GOUVERNEMENT DE LA RÉPUBLIQUE FRANÇAISE

CONTRIBUANT À LA RÉALISATION DE PROJETS PRIORITAIRES

EN ALBANIE

Le Conseil des ministres de la République d'Albanie et le Gouvernement de la République française (ci-après «les Parties»),

En vue de renforcer les liens d'amitié et de coopération qui les unissent, et de favoriser le développement économique de la République d'Albanie,

Désireux de développer un nouveau cadre de coopération stratégique favorisant les échanges et le développement économique,

Désireux de contribuer au développement des infrastructures et des services pour répondre aux défis économiques, démographiques, sociaux, sociétaux et environnementaux,

Désireux de partager les savoir-faire et technologies, en conformité avec les meilleurs standards internationaux, notamment en matière de services environnementaux, de sécurité et de mobilité,

Désireux de contribuer ensemble à la préparation de l'Albanie à l'adhésion à l'Union européenne,

Considérant la Feuille de route de coopération économique entre la République d'Albanie et la République française signée à Tirana le 17 octobre 2023,

Rappelant le Traité d'entente, d'amitié et de coopération entre la République d'Albanie et la République française signé le 12 décembre 1994,

Réitérant l'importance de la lutte contre la corruption dans les transactions commerciales internationales et tenant compte des normes définies par la Convention de l'Organisation de coopération et de développement économique (OCDE),

Encourageant le respect des normes environnementales et sociales reconnues par la communauté internationale, parmi lesquelles figurent les conventions internationales de l'Organisation Internationale du Travail (OIT), les conventions internationales de l'Organisation des Nations Unies en matière de changement climatique, de biodiversité, et d'environnement, ainsi que les normes de performance de la Société Financière Internationale,

Agissant sur une base d'égalité et de bénéfices mutuels,

Sont convenus des dispositions suivantes:

ARTICLE 1^{er} – OBJET DU PRÉSENT ACCORD

Les Parties engagent des actions de coopération dans le but d'identifier et de mettre en œuvre des projets stratégiques prioritaires en République d'Albanie dans les domaines du tourisme, de la gestion de l'eau, de l'environnement, de l'innovation, de la numérisation, de l'énergie, de la réforme de l'administration publique, du transport, de l'éducation, de la santé et de l'agriculture. Les Parties développent ces projets stratégiques prioritaires de manière à faciliter les transferts de technologie, le développement professionnel de la main-d'œuvre qualifiée et non qualifiée, en s'efforçant de contribuer à la préparation de la République d'Albanie à l'adhésion à l'Union européenne.



A ces fins, les Parties partagent les informations pertinentes relatives à ces projets et identifient des financements concourant à leur mise en œuvre, dans le respect des normes de financement soutenable, en particulier les principes pour l'investissement responsable des Nations Unies et les principes pour l'investissement dans des infrastructures de qualité du G20.

ARTICLE 2 – MODES DE COOPÉRATIONS PRIORITAIRES

Les Parties coopèrent pour la mise en œuvre des projets en République d'Albanie, qui sont, à ce stade:

- La contribution à la modernisation de l'infrastructure et de la gestion des services publics, de gestion de l'eau, traitement des déchets et recyclage, à Tirana et à Durrës, pour parvenir aux normes européennes ;
- Le développement de l'écosystème d'innovation et le renforcement des infrastructures digitales de e-gouvernement, incluant la cybersécurité et la cyber-résilience ;
- La modernisation the secteur de l'énergie pour favoriser l'amélioration du réseau énergétique – production, transmission et distribution – ainsi que des énergies renouvelables et de l'efficacité énergétique, et le potentiel développement de nouvelles sources d'énergie
- Le développement du tourisme durable avec une attention particulière à la région de Korca, notamment dans le tourisme de montagne ;
- Infrastructures d'irrigation, lutte contre les inondations,
- L'optimisation de la gestion des ressources humaines en particulier dans la modernisation du secteur public,
- L'encouragement de la coopération dans le domaine de l'enseignement préuniversitaire, y compris l'enseignement et la formation professionnels (EFP), l'enseignement supérieur et la recherche scientifique.
- L'encouragement de l'ouverture et du fonctionnement d'établissements d'enseignement préuniversitaire français en République d'Albanie, d'établissements d'enseignement supérieur français ou de leurs antennes, dont les modalités d'organisation et de fonctionnement seront déterminées dans les actes d'ouverture pertinents, où, le cas échéant, les procédures de ratification internes seront suivies, sur la base de la législation en vigueur, y compris l'ouverture de programmes d'études conjoints dans les établissements d'enseignement supérieur respectifs pour les deux pays.



Les projets dans d'autres domaines identifiés dans la Feuille de route économique et le Traité d'entente, d'amitié et de coopération mentionnés dans le préambule, notamment dans les domaines de l'agriculture, de l'énergie et des infrastructures, seront développés conjointement. En outre, dans le cadre de la réforme de l'administration publique albanaise et de son objectif d'intégration européenne, les Parties s'engagent à faciliter les échanges de connaissances, défis actuels et d'approches novatrices dans le domaine des politiques d'administration publique, en mettant l'accent sur la progression constante de la professionnalisation, de la transformation et de la modernisation du secteur public.

Un comité mixte de suivi identifiera les possibilités de nouveaux projets et évaluera les progrès dans ces domaines, ainsi que la mise en œuvre des projets susmentionnés, et fera rapport aux Parties, tel qu'il figure à l'annexe 1, qui fait partie intégrante du présent accord.

Dans le secteur de l'innovation, un Conseil de l'innovation France-Albanie proposera aux deux Parties des actions susceptibles de contribuer à la réalisation des objectifs mentionnés dans le présent accord et dans la Feuille de route, tel qu'il figure à l'annexe 2, qui fait partie intégrante du présent accord.

Les activités mentionnées dans le présent accord seront proposées et développées par les autorités compétentes et, le cas échéant, par des entités privées compétentes dans le cadre d'accords, de contrats, de programmes ou de projets spécifiques. Les Parties conviennent que les entreprises françaises et albanaises participeront à la mise en œuvre des projets, conformément aux procédures convenues entre les Parties.

La mention des projets du Groupe de l'Agence française de développement dans le présent accord est indicative. Ces projets particuliers suivront les procédures de préparation et de traitement ainsi que les procédures de mise en œuvre et les lignes directrices propres au Groupe.

La mise en œuvre des projets existants et futurs dans le cadre du présent accord peut prendre la forme de:

- Études de pré faisabilité et de faisabilité pour identifier de nouveaux projets, ainsi que la mise en œuvre des projets mentionnés dans le présent accord;
- Travaux de génie civil et de construction et services de conseil pour la gestion de projets, la supervision et la préparation de leur exploitation et de leur entretien;
- Achat de machines, d'équipements et de services nécessaires à la réalisation et à l'entretien desdits projets;
- Assistance technique pour soutenir la mise en œuvre des projets, le renforcement des capacités et le renforcement institutionnel, soit par le déploiement d'experts techniques, soit par le biais de programmes de coopération technique ad hoc;
- Autres formes de coopération convenues entre les Parties.

ARTICLE 3 – OUTILS DE FINANCEMENT DISPONIBLES

Le Gouvernement de la République française confirme son intérêt pour un appui à des projets stratégiques prioritaires en République d'Albanie ainsi que pour envisager



l'engagement de ses instruments de financement. Le Groupe AFD est aussi disposé à mettre à disposition du Gouvernement de la République d'Albanie une offre de financement de projets, en intégrant les transitions vers des trajectoires de développement durable, dans le respect de l'Accord de Paris sur le climat et de la convergence à l'UE.

Les sources de financement disponibles de la Partie française sont notamment, mais non exclusivement, celles énumérés ci-après:

- les dons du Fonds d'étude et d'Aide au Secteur Privé (ci-après dénommés « dons FASEP ») sont consacrés à la réalisation par des entreprises françaises d'études de faisabilité et de projets pilotes au bénéfice d'entités publiques albanaises ;
- les prêts directs du Trésor sont des prêts souverains régis par les règles de l'Arrangement de l'OCDE sur les crédits à l'exportation bénéficiant de soutiens publics (ci-après, « l'Arrangement de l'OCDE »), finançant la mise en œuvre de projets stratégiques prioritaires portés par des entreprises françaises au bénéfice d'entités publiques dans des pays étrangers ;
- les garanties publiques à l'exportation, gérées par l'agence de crédit export Bpifrance Assurance Export, agissant au nom et pour le compte de la République française, pourront être octroyées au cas par cas pour soutenir des projets stratégiques prioritaires éligibles en République d'Albanie, conformément à la stratégie française en matière de garantie des crédits à l'exportation et aux lois et règlements applicables, notamment, mais non exclusivement, l'Arrangement de l'OCDE ;
- les prêts souverains, les prêts non souverains, les fonds d'assistance technique pour le déploiement des experts internationaux, les subventions et garanties accordées par les membres du Groupe AFD.

Les dons FASEP, les prêts directs ou concessionnels du Trésor et les garanties publiques sont soumis à l'approbation d'un Comité interministériel français, conformément aux politiques internes de la Direction générale du Trésor français et aux règles applicables de l'OCDE.

Les financements du Groupe AFD doivent être approuvés par les instances décisionnelles du Groupe AFD (y compris des filiales) qui se prononcent en fonction de l'intérêt développemental des projets et des considérations, notamment financières, propres au Groupe.

La République d'Albanie peut également choisir une autre forme de financement des projets prioritaires mentionnés, en fonction des conditions financières et des capacités budgétaires du Gouvernement de la République d'Albanie.

ARTICLE 4 – MOBILISATION DES FONDS

La mobilisation d'un don FASEP doit donner lieu à la signature d'un protocole d'accord entre le prestataire de service français et le bénéficiaire albanais.



Si les Parties conviennent de la mobilisation de prêts directs ou concessionnels du Trésor français ou de crédits bancaires garantis par Bpifrance Assurance Export agissant au nom et pour le compte de la République française, des accords spécifiques seront conclus et ratifiés.

La mobilisation d'un prêt direct du Trésor requiert la signature d'un protocole financier entre le Gouvernement de la République d'Albanie et le Gouvernement de la République française. Une convention de financement doit ensuite être signée entre BPI France, agissant au nom et pour le compte du Gouvernement de la République française, et le Gouvernement de la République d'Albanie.

La mobilisation de crédits bancaires garantis par Bpifrance Assurance Export requiert la signature d'un accord de crédit entre les institutions bancaires et l'emprunteur. Cet accord doit définir les modalités d'utilisation des crédits bancaires garantis, ainsi que les conditions de prêt qui s'y rattachent, incluant les conditions de financement de la prime de risque en conformité avec les règles de l'Arrangement de l'OCDE.

La mobilisation des sources de financement du Groupe AFD donne lieu à la signature de conventions de financement spécifiques en fonction de la source de financement concernée.

Le déploiement d'experts techniques internationaux nécessite une manifestation d'intérêt de l'administration d'accueil adressée au ministère français des Finances. Expertise France (l'agence de coopération technique du Groupe AFD) sera chargée de mobiliser l'expertise en Albanie.

Les montants alloués aux projets mentionnés aux articles 6 à 9 sont indicatifs et les conditions de leurs financements seront spécifiées par les protocoles financiers, accords de crédits, et conventions de financement signés pour chaque projet.

ARTICLE 5 – MODALITÉS DES CONTRATS COMMERCIAUX

La mise en œuvre et la réalisation des projets prévus par le présent accord sont régies par des accords spécifiques relatifs à l'exportation, la fourniture de biens et de services ou à de la construction, préparés par les autorités et institutions compétentes et les sociétés des Parties, avec l'approbation des autorités publiques des deux pays et conformément aux législations respectives des Parties (ci-après dénommés «contrats commerciaux»).

Le présent accord détermine que les règles et procédures pour les marchés visés au premier paragraphe du présent article sont les suivantes :

- Pour les contrats et opérations financés par des prêts directs, les règles et procédures de sélection des fournisseurs, telles que prévues par le cadre juridique français, sont appliquées.
- Pour les contrats financés par les subventions FASEP, le Gouvernement de la République française fournit aux autorités compétentes albanaises les



fournisseurs qualifiés et sélectionnés qui exécuteront le projet. Les modalités de sélection du lauréat du projet seront définies dans des conventions financières distinctes.

- Pour les opérations financées ou mises en œuvre par le Groupe AFD, les modalités des contrats seront régies par les directives de passation des marchés applicables au Groupe AFD ou à d'autres parties prenantes en cas de cofinancement.

Les concours financiers pour la réalisation desdits contrats sont assurés par les outils de financement mentionnés à l'article 3 du présent accord ou par un autre outil de financement acceptable pour la République d'Albanie.

La valeur de tous les contrats concernés, financés par les concours financiers, est exprimée en euro sauf accord contraire entre les Parties

ARTICLE 6 – CONCOURS FINANCIERS POUR LES PROJETS DANS LE SECTEUR DE L'EAU

Le partenariat stratégique entre la France et l'Albanie pour le développement de services publics de qualité aux normes de l'Union européenne s'appuiera sur le projet prioritaire de modernisation du réseau d'adduction d'eau de Tirana, en lien avec la préparation d'un contrat d'affermage.

Les concours financiers mobilisés à cette fin comprennent :

- une subvention pour l'assistance technique utilisée pour préparer l'appel d'offres pour le contrat d'affermage;
- un prêt direct du Trésor français d'un montant maximum de 90 millions d'euros pour la modernisation du réseau d'eau de la ville ("mini-zone").

Le Groupe AFD a été sélectionné comme IFI chef de file pour la préparation et le financement des projets suivants :

- Reconstruction du réseau d'assainissement du centre historique de Durrës (projet WB25-ALB-ENV, CIBO 2024) ;
- Réhabilitation des réseaux d'assainissement dans les zones résidentielles de Durrës (Spitalle & Portoromano).

ARTICLE 7 – CONCOURS FINANCIERS POUR LES PROJETS CONTRIBUANT À L'INNOVATION ET À LA NUMÉRISATION

Un financement sera accordé aux projets suivants :



- Assistance technique pour le développement d'un centre de continuité des opérations e-gov, et potentiellement un prêt de trésorerie potentiel pour la réalisation du projet ;
- Assistance technique pour étudier l'environnement des investissements dans le secteur numérique.

ARTICLE 8 – CONCOURS FINANCIERS POUR DES PROJETS DANS LE SECTEUR DU TOURISME

Les projets suivants seront financés :

- Une étude pour l'élaboration d'un schéma directeur de développement durable du tourisme pour la région de Korça ;
- En lien avec les projets de coopération entre les établissements d'enseignement public, une assistance technique pour étudier les conditions de développement de la formation professionnelle dispensée par des opérateurs français dans le secteur du tourisme.

ARTICLE 9 – CONCOURS FINANCIERS POUR LES PROJETS DANS LE DOMAINE DE L'AGRICULTURE

Les projets suivants seront financés :

- Étude de faisabilité, conception détaillée et reconstruction/modernisation physique de l'infrastructure d'irrigation par élévation mécanique de l'eau (stations de pompage pour l'irrigation), principalement dans la zone côtière occidentale.

Le Groupe AFD s'efforcera de répondre aux demandes exprimées par les autorités albanaises dans les secteurs prioritaires mentionnés aux articles 6 à 9 en privilégiant le financement de projets concrets au plus près des besoins des citoyens et des entreprises.

ARTICLE 10 – ENREGISTREMENT DES PROTOCOLES FINANCIERS ET DES CONTRATS COMMERCIAUX

L'enregistrement au titre du présent accord des protocoles financiers qui encadrent les dispositions de financement mentionnées aux articles 6 à 9 et de chaque contrat mentionné à l'article 5 du présent accord est soumis à :

- (i) La conformité du contrat avec les recommandations formulées par la pré-évaluation du projet correspondant audit contrat, ainsi que son contenu, y compris les services fournis et les prix, par le Conseil des ministres de la



République d'Albanie et le Gouvernement de la République française, sauf pour les opérations du Groupe AFD ;

(ii) la conformité du projet avec les dispositions de l'Arrangement de l'OCDE pour les crédits à l'exportation bénéficiant d'un soutien public, sauf pour les opérations du Groupe AFD ;

(iii) les montants dus et payables par le Conseil des ministres de la République au Gouvernement de la République française ;

(iv) les montants dus et payables par le Conseil des ministres de la République d'Albanie à l'Agence française de développement (AFD) ;

(v) les montants dus et payables au titre des crédits bancaires garantis par la République française ;

(vi) le respect des engagements contenus dans les articles 12 et 13 du présent accord.

ARTICLE 11 – DATES LIMITES DES CONCOURS FINANCIERS

Pour bénéficier des prêts directs du Trésor français, les dates limites d'imputation des contrats et de tirage sont spécifiées en accord entre les Parties par chaque protocole financier afférent au projet qui fait l'objet du financement.

Ces dates ne peuvent être prorogées qu'en cas de circonstances exceptionnelles après accord mutuel par un échange de lettres entre les Parties.

ARTICLE 12 – ENGAGEMENTS EN FAVEUR DE LA LUTTE CONTRE LA CORRUPTION

Les Parties ont rappelé dans le préambule leur engagement à lutter contre la corruption dans les transactions commerciales internationales.

Les parties aux contrats enregistrés dans le cadre du présent accord ne doivent ni offrir ni donner à un tiers, ni rechercher, accepter ou se faire promettre, directement ou indirectement, pour elles-mêmes ou pour une autre partie, un avantage indu, pécuniaire ou autre, qui constituerait ou pourrait constituer une pratique illégale et de corruption.

Les Parties s'engagent à veiller à ce que le projet ne donne pas lieu à des pratiques de corruption. Les Parties s'engagent à s'informer mutuellement dès qu'elles ont connaissance d'informations donnant lieu à des soupçons et à agir de manière appropriée pour remédier à la situation, avant un délai donné et à la satisfaction de chaque Partie.

En cas de non-respect de ces engagements, le Gouvernement de la République française se réserve le droit de refuser l'enregistrement d'un contrat et/ou de suspendre le versement du soutien financier accordé au Conseil des ministres de la République d'Albanie.



ARTICLE 13 – ENGAGEMENTS EN FAVEUR DE LA RESPONSABILITÉ SOCIALE ET ENVIRONNEMENTALE

Afin de promouvoir le développement durable, les Parties s'accordent sur le fait qu'il est nécessaire d'encourager la conformité aux normes sociales et environnementales reconnues par la communauté internationale, dont les conventions internationales de l'Organisation Internationale du Travail et des Nations Unies sur le changement climatique, la biodiversité et l'environnement.

ARTICLE 14 – ÉVALUATION A POSTERIORI DES PROJETS

Le Gouvernement de la République française peut procéder à ses frais à l'évaluation a posteriori du projet sur les plans économique, financier et comptable afin d'apprécier son impact sur le développement économique de l'Albanie. Le Conseil des ministres de la République d'Albanie peut participer à cette évaluation, selon des modalités à définir, afin de bénéficier directement des résultats. Le Conseil des ministres de la République d'Albanie s'engage à recevoir la mission de post-évaluation envoyée par le Gouvernement de la République française et à lui faciliter l'accès aux informations relatives au projet.

Les projets financés par le Groupe AFD sont évalués selon ses procédures spécifiques, conformément aux termes des conventions de financement. Ces évaluations interviennent en lien étroit avec les autorités compétentes de la République d'Albanie.

ARTICLE 15 – ENTRÉE EN VIGUEUR

Le présent accord entre en vigueur à la date de réception de la dernière notification écrite par laquelle les Parties s'informent mutuellement, par la voie diplomatique, de l'accomplissement des procédures juridiques internes requises pour l'entrée en vigueur du présent accord.

ARTICLE 16 – IDENTIFICATION DE NOUVEAUX PROJETS

Les projets stratégiques prioritaires pouvant bénéficier de concours financiers du Gouvernement de la République française, identifiés ultérieurement à la signature du présent accord, peuvent être ajoutés au présent accord par échange de lettres signées par les Parties.

ARTICLE 17 – AVENANT AU PRÉSENT ACCORD Y COMPRIS LA MODIFICATION DES MONTANTS DES CONCOURS FINANCIERS

Le présent accord peut être modifié par accord mutuel écrit entre les Parties. Les montants du soutien financier peuvent être modifiés par accord mutuel écrit. Ces modifications



font partie intégrante du présent accord et entrent en vigueur selon les modalités prévues à l'article 15 du présent accord.

ARTICLE 18 – RÈGLEMENT DES DIFFÉRENDS

Tout différend relatif à l'interprétation ou à la mise en œuvre du présent accord est réglé à l'amiable par voie de consultations ou de négociations entre les Parties.

ARTICLE 19 – DÉNONCIATION

Chaque Partie peut mettre fin à tout moment au présent accord. La Partie qui souhaite mettre fin au présent accord notifie son intention à l'autre Partie par écrit. La dénonciation du présent accord prend effet six mois après la réception de la notification par l'autre Partie.

La dénonciation du présent accord n'affectera pas les projets et programmes conjoints entamés avant sa dénonciation.

EN FOI DE QUOI, les représentants des deux Parties, dûment autorisés par leurs gouvernements respectifs, ont signé le présent accord.

Fait à Paris, le 12.04.2024

En deux exemplaires originaux, en langues albanaise et française, les deux versions faisant également foi.

**Pour le Conseil des ministres de la
République d'Albanie**


Blendi GONXHJA
**Ministre de l'Économie, de la Culture et
de l'Innovation**

**Pour le gouvernement de la République
française**


Jean-Noël BARROT
Ministre délégué chargé de l'Europe



ANNEXE 1 - Comité mixte de suivi

En référence à l'article 2, il est institué un comité mixte de suivi de la mise en œuvre de l'accord.

1 - Composition :

Le comité mixte de suivi est composé de :

- Pour la Partie albanaise :
 - Le chef de cabinet du ministère de l'Europe et des affaires étrangères
 - Le conseiller diplomatique du Premier ministre
- Pour la Partie française:
 - L'Ambassadeur de France en Albanie
 - Le chef du service économique régional de la France compétent pour l'Albanie

2 – Modalités

Le comité mixte de suivi tient une réunion trimestrielle à un endroit et sous un format convenu entre les Parties et fait rapport à ses autorités respectives.

Des preneurs de notes sont prévus par chacune des Parties pour la rédaction des rapports (en langue anglaise).

Le comité mixte de suivi est habilité à inviter des experts et/ou des parties prenantes à participer aux réunions en fonction de l'ordre du jour.

Le Conseil albanais - franco pour l'innovation (annexe 2) fait rapport au comité mixte de suivi conformément à l'ordre du jour.

Au moins une fois par an après l'entrée en vigueur de l'accord, le comité mixte de suivi produit un rapport complet (en langues française et albanaise) sur la mise en œuvre de l'accord conformément à l'article 2 de celui-ci.



Annexe 2 : Conseil de l'innovation Albanie - France - CIFA

En référence à l'article 2 de l'accord, un Conseil de l'innovation Albanie - France - CIFA est créé comme suit :

1- Objectif général

Le CIFA réunit des représentants des Parties et des parties prenantes externes de différents domaines d'innovation afin d'apporter des idées et des conseils pour faciliter le développement de l'infrastructure numérique et de l'écosystème de l'innovation, au profit des acteurs en Albanie et en France.

En référence à la feuille de route économique signée en 2023 et à l'accord, le CIFA s'efforce de contribuer au renforcement de la relation bilatérale, notamment dans les domaines suivants:

- Transfert de connaissances à partir des structures françaises d'innovation, privées et publiques ;
- Coopération entre autorités/agences ;
- Besoins de financement de l'infrastructure numérique ;
- Stratégie de développement du secteur numérique en Albanie.

En coopération avec les organisations françaises et albanaises, **le CIFA peut proposer d'autres domaines de coopération pour l'innovation.**

2- Lignes directrices opérationnelles

Le CIFA adopte une approche collaborative où chacun est entendu.

Le travail du CIFA est basé sur la feuille de route économique Albanie - France qui est mise à jour annuellement par les gouvernements en fonction des priorités de la coopération albanaise – franco dans le domaine de l'innovation.

Il s'attache à organiser ces priorités et il rend compte aux deux gouvernements à intervalles réguliers, au moins deux fois par an.

Il définit des indicateurs de progrès, qu'il fait approuver par les deux gouvernements, et en assure le suivi.

Le CIFA se réunit au moins une fois par trimestre.

Les réunions peuvent être organisées en visio-conférence mais elles se tiennent au moins une fois par an en personne.



Les travaux sont organisés avec le soutien de l'ambassade de France en Albanie, l'ambassade d'Albanie en France et le service économique régional pour les Balkans occidentaux.

Le comité peut établir des règles de fonctionnement interne, pour faire en sorte par exemple que ses membres aient un "état d'esprit constructif" - en se concentrant sur les possibilités plutôt que sur les contraintes.

Le CIFA pourra définir des principes de fonctionnement au cours de la première réunion avec des outils communs tels que la méthode agile, des conseils pour aider les membres à cadrer les questions, etc.

3- Sélection des membres du Conseil de l'innovation

Le CIFA devrait être composé d'un nombre impair de membres, qui sera convenu entre les Parties, personnalités des secteurs public et privé, notamment de la diaspora albanaise dans le secteur de la technologie et de l'innovation.

Les membres devraient avoir des compétences et des expériences diverses.

Ils sont nommés pour 2 ans, après un processus de sélection par pré-identification et entretiens.

Les membres du CIFA s'engagent à fournir une quantité de travail en plus des réunions du CIFA. Ils peuvent être choisis notamment parmi :

- Des personnalités de la diaspora albanaise en France susceptibles de constituer un pont avec les institutions et les entreprises françaises:
 - Des responsables du secteur privé dans les domaines de la technologie, du numérique et du financement d'amorçage;
 - Des spécialistes de l'innovation dans l'éducation, les universités;
- Les investisseurs français dans le secteur numérique en Albanie ; la French Tech ; BPI France ; l'AFD ;
- Personnalités en Albanie :
 - de l'administration publique (par exemple le secrétaire général du ministère en charge de l'innovation) ;
 - du secteur privé avec une grande expérience dans le domaine du numérique et de l'innovation ;
 - des institutions financières ;
 - du secteur de l'éducation.



4- Communication sur le rôle du CIFA à toutes les organisations concernées

Le rôle et les activités du CIFA doivent faire l'objet d'une communication claire et cohérente auprès des parties prenantes concernées. Cela permet de s'assurer que les personnes qui s'engagent avec le Conseil ainsi que les autres fonctions de gouvernance des gouvernements ont des attentes claires et peuvent gérer leurs interactions avec le Conseil en conséquence.

5- Mesurer le succès

Suivre les progrès du Conseil de l'innovation Albanie - France à l'aide d'indicateurs clés de performance (ICP).

Programme de travail initial

Le CIFA s'appuie sur les projets existants inclus dans l'accord et sur les objectifs fixés dans la feuille de route économique de 2023.

Les questions à traiter sont les suivantes :

- Besoins en infrastructures numériques : les entreprises françaises peuvent-elles aider ?
- Comment l'organisation institutionnelle peut-elle être améliorée (en référence aux discussions avec BPI France) ?
- Comment la French Tech peut-elle aider l'Albanie à devenir un centre régional d'innovation ?
- Projets de coopération : open data et collectivités locales ; plateforme Euroquity ; Ecole 42 ; Station F ou une structure équivalente.
- Investissement dans les services numériques : l'Albanie est-elle prête, l'environnement peut-il être amélioré ?
- Intelligence artificielle, services numériques et politique active de l'emploi.



DEKRET
Nr. 248, datë 11.7.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 64/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 463, datë 10.7.2024

PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR
PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR
ORGANET E VETËQEVERISJES
VENDORE, NË BASHKINË HIMARË,
TË DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 87, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i shtohet fondi prej 28 340 000 (njëzet e tetë milionë e treqind e dyzet mijë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme për organet e

vetëqeverisjes vendore, në Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 465, datë 17.7.2024

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 1179, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR RREGULLAT E
PËRDORIMIT, ADMINISTRIMIT DHE
RUAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE
PËR PASURITË E PALUAJTSHME DHE
PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INSTITUCIONEVE QË KANË TË
DREJTËN E AKSESIT NË SISTEMIN
ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1179, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave”, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 7, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) të dhënat e regjistrit të lejes së ndërtimit.”.

2. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Të dhëna parësore të regjistrit të lejes së ndërtimit, pjesë e bazës shtetërore të të dhënave kadastrale (ALBSCAD) janë:



a) dokumentacioni tekniko-ligjor, i cili përfshin praktikën administrative të regjistrimit të lejes së ndërtimit, aktet juridike paraprake (kontratat e sipërmarrjes/porosisë/premtimshitjes), vendime gjyqësore dhe akte administrative apo akte të tjera për vendosjen e hipotekave, të cilat merren drejtpërdrejt nga sistemi me aplikimin për shërbim nga platformat digjitale, ashtu edhe në format shkresor;

b) akte kadastrale, të krijuara nga veprimtaria administrative e ASHK-së, si pasojë e regjistrimit të lejes së ndërtimit dhe akteve juridike paraprake (kontrata e sipërmarrjes/porosisë apo premtimshitjes) në regjistrin e lejes;

c) skeda digjitale e regjistrit të lejes.”.

3. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Të dhënat dytësore të regjistrit të lejes së ndërtimit, pjesë e bazës shtetërore të të dhënave kadastrale (ALBSCAD), janë:

a) Të dhënat identifikuese për shtetasit, të cilat merren nga baza e të dhënave “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si:

- i. numri personal;
- ii. emri;
- iii. mbiemri.

b) Të dhëna identifikuese për subjektin, të cilat merren nga baza e të dhënave “Regjistri tregtar”, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si:

- i. NIPT/NUIS;
- ii. emërtimi tregtar.

c) Të dhënat e lejes së ndërtimit, të cilat merren nga baza e të dhënave “Databaza e lejeve të ndërtimit *e-Leje*”, administruar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, si:

- i. numër akti;
- ii. data e aktit;
- iii. autoriteti përgjegjës që ka miratuar lejen;
- iv. lloji i lejes së ndërtimit, sipas përshkrimit të aktit të miratuar;

v. sipërfaqja e ndërtimit, sipas projektit të lejes;

vi. sipërfaqja e tokës, e zënë nga struktura e ndërtimit, sipas lejes;

vii. numri i kateve mbi dhe nën tokë;

viii. numri i njësive;

ix. investitori/subjekti zhvillues;

x. pjesët takuese të investitorit/subjektit zhvillues mbi ndërtimin për të cilin është miratuar leja.”.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 466, datë 17.7.2024

PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 50 (pesëdhjetë) apartamenteve në 1 (një) ndërtesë me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



Lista e inventarit të objekteve të përfunduara në zonën “5 Maji” (të kolauduara)

Nr.	Emërtimi i kontratës	Vlera e objektit sipas Kontratës (ndërtim+montim+projektim)	Vlera e situacionit përfundimtar (ndërtim+montim)	Vlera e studim-projektimit	Vlera e mbikëqyrjes së punimeve	Vlera e kolaudimit të punimeve	Vlera totale	Sipërfaqe total ndërtimi (m²)	Sipërfaqe banimi ap. (m²)	Sipërfaqe e njërive të shërbimit	Sipërfaqja e katit 1	Hapësirë e përbashkët (kati 1 + kati përdhes+kate banimi +kafaz ashensor+pandus+pasazh)	Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	Total apartamente (nr.)
1	Banesë kolektive, Godina 21	338,995,000.00	332,207,325.00	5,500,000.00	3,034,128.05	110,000.00	340,851,453.05	7,526.06	4,267.85	890.94	1,310.46	1,056.81	15	30	5	50



VENDIM

Nr. 467, datë 17.7.2024

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TE
BASHKIA TIRANË TË OBJEKTIT
“GODINË E SHËRBIMEVE
KOMUNITARE, VAQARR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi te Bashkia Tiranë të objektit “Godinë e shërbimeve komunitare, Vaqarr”, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Të dhënat e përmbledhura për objektin / BASHKIA TIRANË

Nr.	Qarku	Bashkia	Njesia Administrative	Niveli	Emertimi i objektit	Tipologjia e Ndërhyrjes	Financimi i Ndërtimit	Sipërfaqe Totale Ndërtimit (m ²)	Vlera e Studim Projektimit	Vlera e zbatimi të ndërtimit	Vlera e Mbikqyrësit	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
1	Tiranë	Tiranë	Vaqarr	Qëndër Komunitare	Godina e Shërbimeve Komunitare Vaqarr	Ndërtim i ri	Rindërtim	1,580	950,000	93,941,319	799,900	40,000	95,731,219
TOTAL								1,580		93,941,319	799,900	40,000	95,731,219

VENDIM

Nr. 468, datë 17.7.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E SASISË NË
PËRQINDJE TË SIPËRFAQES SË
STOKUT TË NDËRTESAVE PUBLIKE
PËR T’U RINOVUAR ÇDO VIT,
KUNDREJT SIPËRFAQES TOTALE TË
STOKUT TË NDËRTESAVE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 9/4, të ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi në përqindje i sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t’u rinovuar çdo vit, kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, sektori publik ngarkohet me zbatimin e objektivit, të përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 9/4, të ligjit nr.

124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar.

3. Ky vendim shtrin efektet e tij për të gjitha ndërtesat në pronësi ose në përdorim nga:

- organet e qeverisjes qendrore;
- organet e qeverisjes vendore;
- institucionet e varësisë.

4. Rinovimet që do të realizohen prej institucioneve, të përmendura në pikën 3, të këtij kreu, garantojnë të paktën zbatimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë, sipas vendimit nr. 537, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave”.

5. Çdo rinovim realizohet duke u bazuar mbi rezultatet e auditimit të energjisë, i cili duhet të shoqërohet me një analizë të veçantë të kosto-përfitimit për çdo ndërtesë që kualifikohet.

6. Ndërtesat, të cilat kanë një performancë të ulët energjetike dhe që shfrytëzohen ose strehojnë fëmijë të sëmurë ose persona të moshuar, kanë përparësi në realizimin e rinovimit edhe kur nuk plotësohet kriteri i kostos optimale.



II. METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SIPËRFAQES SË STOKUT DHE PËRZGJEDHJES SË NDËRTESAVE QË DO TË RINOVohen

1. Sipërfaqja e stokut të ndërtesave publike përfshin të gjitha ndërtesat që nuk përjashtohen sipas nenit 4, të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë përgatit inventarin e të gjitha ndërtesave publike, të identifikuara sipas pikës 3, të kreut I, ku përcaktohet sipërfaqja (në m²) që do të rinovohet çdo vit për ndërtesat e zëna nga organet e qeverisjes qendrore dhe ndërtesat e tjera publike.

3. Inventari i ndërtesave publike miratohet me urdhër nga ministri përgjegjës për energjinë dhe përmban informacionin sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Inventari i ndërtesave publike rishikohet çdo 10 (dhjetë) vjet.

4. Brenda 6 (gjashtë) muajve, pas miratimit të inventarit të ndërtesave publike dhe para 31 marsit të çdo viti pasardhës, agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, përpilon listën e ndërtesave që kualifikohen për t’iu nënshtruar rinovimit, sipas metodologjisë së pikëzimit, të paraqitur në shtojcën IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në funksion të metodologjisë për pikëzimin dhe kualifikimin e ndërtesave përdoren gradë-ditët e ngrohjes, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Lista e ndërtesave, që kualifikohen për t’iu nënshtruar rinovimit, miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë çdo vit, në përputhje me objektivat kombëtarë të eficiencës së energjisë.

7. Sipërfaqja totale e ndërtesave të kualifikuara duhet të jetë më e madhe ose e barabartë me sipërfaqen e miratuar në inventar për secilën kategori. Diferenca me sipërfaqen e detyrueshme për t’u rinovuar çdo vit reflektohet në listën e ndërtesave që kualifikohen për t’iu nënshtruar rinovimit për vitin pasardhës.

8. Ndërtesat, që i janë nënshtruar një rinovimi mbi mbështjellësen e ndërtesës ose sistemet teknike, mund të përfshihen në inventarin e ndërtesave që do të rinovohen vetëm pas 10 (dhjetë) vjetësh, prej datës së përfundimit të rinovimit.

III. PROCEDURA PËR ZBATIMIN E PROCESIT TË RINOVIMEVE

1. Institucionet, të cilat kanë prona në përgjegjësi administrimi, parashikojnë buxhetin për vitin pasardhës, në përputhje me listën e miratuar të ndërtesave që kualifikohen për t’iu nënshtruar rinovimit, sipas pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Kostot e nevojshme për realizimin e investimit llogariten sipas metodologjisë së kostos optimale dhe specifikohen për çdo ndërtesë në listën e miratuar.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në rastet kur nuk zotërojnë fondet e mjaftueshme, kërkojnë mbështetje financiare nga qeverisja qendrore, sipas parashikimeve të nenit 22, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

4. Investimi realizohet vetëm nëse analiza e kosto-përfitimit rezulton pozitive, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me ndërtesa që shfrytëzohen nga të sëmurët, të moshuarit mbi 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç dhe fëmijët nën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

5. Analiza ekonomike për realizimin e rinovimit dhe përzgjedhjen e masave që do të implementohen hartohet sipas rezultateve të auditimit të energjisë.

6. Me përfundimin e investimit, audituesi i energjisë bën vlerësimin e parametrave të përmirësuar dhe i raporton tek Agjencia për Eficiencën e Energjisë. Agjencia përfshin kritere të detyrueshme që audituesit e energjisë duhet të plotësojnë, kur një ndërtesë i nënshtrohet procesit të rinovimit, sipas këtij vendimi.

7. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, kur e vlerëson të nevojshme, dërgon rekomandimet për çdo rinovim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i marrjes dijeni.

8. Të gjitha institucionet, që kanë në pronësi ose në përdorim ndërtesa, sipas pikës 3, të kreut I, njoftojnë agjencinë përgjegjëse për eficiencën e energjisë për rinovimet që parashikojnë të kryejnë në objektet e tyre, në përputhje me listën e miratuar të ndërtesave që do t’i nënshtrohen rinovimit, shoqëruar me informacionin e kërkuar, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ky njoftim bëhet përpara shpalljes së procedurës për realizimin e rinovimit, në përputhje me raportin e auditimit të energjisë.



IV. MONITORIMI I KURSIMEVE TË ENERGJISË

1. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë është institucioni përgjegjës për monitorimin e kursimeve të energjisë.

2. Për çdo ndërtesë të rinovuar, autoriteti kontraktues dërgon tek Agjencia për Eficiencën e Energjisë informacionin e përcaktuar sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Informacioni i përfituar sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, plotësohet në platformën e monitorimit dhe verifikimit, të ngritur për këtë qëllim.

4. Agjencia për Eficiencën e Energjisë raporton çdo vit te ministria përgjegjëse për energjinë përcurinë e procesit të rinovimeve gjatë vitit paraardhës.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë përgatit inventarin e të gjitha ndërtesave publike, të identifikuar sipas pikës 3, të kreut I, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Përfshihen nga lista e miratuar e ndërtesave, që do t'i nënshtrohen rinovimit, të gjitha ndërtesat publike të rinovuara ose të ndërtuara pas vitit 2023.

3. Të gjitha rinovimet e ndërtesave publike, të cilat nuk janë të përfshira në listën e miratuar apo që realizohen jashtë planifikimeve të listës së miratuar duhet të raportohen tek Agjencia për Eficiencën e Energjisë, e cila merr masa për mospërfshirjen e tyre në listën e vitit pasardhës.

4. Përfitimet e kursimeve të energjisë prej ndërtesave që do të rinovohen çdo vit përfshihen si pjesë e objektivave të strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA I PYETËSOR PËR RINOVIMET NË NDËRTESA REZIDENCIALE DHE JOREZIDENCIALE

a) Rinovime të fasadës dhe sistemeve teknike

Emërtimi	Njësia	Vlera
Rendimenti i sistemit të ngrohjes para implementimit të masave të energjisë elektrike	%	
Rendimenti i sistemit të ngrohjes pas implementimit të masave të energjinë elektrike	%	
Kërkesa specifike për nxehtësi në ndërtesë përpara ndërhyrjeve për energjinë elektrike	kwh/m ² /vit	
Kërkesa specifike për nxehtësi në ndërtesë pas ndërhyrjeve për energjinë elektrike	kwh/m ² /vit	
Sipërfaqja e kondicionuar e ndërtesës (sipërfaqja e dyshemesë që ngrohet ose ftohet)	m ²	

b) Për rinovime të ndërtesës pa ndryshuar sistemet teknike

Emërtimi	Njësia	Vlera
Kërkesa specifike për energji për ngrohje në ndërtesën referuese para rinovimit	kwh/m ² /vit	
Kërkesa specifike për energji për ngrohje në ndërtesën referuese ku janë zbatuar masat e energjisë elektrike (pas rinovimit)	kwh/m ² /vit	
Energjia specifike e nevojshme për ujë të ngrohtë në vit	kwh/m ² /vit	
Rendimenti (eficiencia) (përdorimi vjetor) i sistemit të ngrohjes në godinën referuese η_{Ref}	%	
η_{Eff} rendimenti (eficiencia) (përdorimi vjetor) i sistemit të ngrohjes në godinën referuese ku janë zbatuar masat e energjisë elektrike (pas rinovimit)	m ²	
Jepen kërkesat për energji specifike për ngrohje përpara rinovimit të veshjes termike	kwh/m ² /vit	
Sipërfaqja e kondicionuar e ndërtesës (sipërfaqja e dyshemesë që ngrohet ose ftohet)	m ²	

c) Pompat e nxehtësisë

Emërtimi	Njësia	Vlera
SHD [kwh/m ² /vit] kërkesa vjetore për nxehtësi në ndërtesë	kwh/m ² /vit	
HWD [kwh/ndërtesë/vit] kërkesa vjetore për ujë të ngrohtë	kwh/m ² /vit	
η_{Ref} – Eficiencia e energjisë në sistemet konvencionale	%	
η_{Eff} – Eficiencia e energjisë në sistemet eficiente të pompave të nxehtësisë	%	
Sipërfaqja e kondicionuar e ndërtesës (sipërfaqja e dyshemesë që ngrohet ose ftohet)	m ²	



ç) Përmirësime të eficiencës së energjisë në sistemin e ngrohjes

Emërtimi	Njësia	Vlera
Kërkesa specifike vjetore për nxehtësi në ndërtesë	kwh/m ² /vit	
η_{rp} – rendimenti i sistemit të vjetër të ngrohjes	%	
η_{cp} – rendimenti i sistemit të ri të ngrohjes	%	
η_{rb} – rendimenti i boilerit të vjetër	%	
η_{re} – rendimenti i pajisjeve ngrohëse të vjetra	%	
η_{rd} – rendimenti i sistemit të vjetër të shpërndarjes	%	
η_{eb} – rendimenti i boilerit të ri eficient	%	
η_{ee} – rendimenti i pajisjeve ngrohëse të reja	%	
η_{rd} – rendimenti i sistemit të ri të shpërndarjes	%	
Sipërfaqja e kondicionuar e ndërtesës (sipërfaqja e dyshemesë që ngrohet)	m ²	

d) Ndriçimi në ndërtesat rezidenciale

Emërtimi	Njësia	Vlera
Numri i llampave të zëvendësuara/shitura	copë	
Fuqia mesatare e llampës ekzistuese	W	
Fuqia e llampës me eficiencë energjetike e promovuar në treg	W	
Koha mesatare vjetore e punës së llampës	h/vit	
Sipërfaqja e dyshemesë së ndërtesës, në të cilën është rinovuar sistemi i ndriçimit	m ²	

dh) Ndriçimi në ndërtesat jorezidenciale

Emërtimi	Njësia	Vlera
Fuqia e instaluar për ndriçim për njësi të sipërfaqes përpara zëvendësimit	W/m ²	
Fuqia e instaluar për ndriçim për njësi të sipërfaqes pas zëvendësimit	W/m ²	
Sipërfaqja e dyshemesë së ndërtesës, në të cilën është rinovuar sistemi i ndriçimit	m ²	

Opsione shtesë: (Shëno me X sipas përgjigjes)	PO	JO
Errësim i pjesshëm		
Kohëmatës interval		
Sensor i okupimit		
Adaptor automatik për dritën natyrale		

e) Pajisjet e zyrës

Emërtimi	Njësia	Vlera
Numri i pajisjeve të reja të instaluar apo atyre të zëvendësuara	Copë	
Fuqia elektrike e pajisjes në funksion aktiv	w	
Fuqia elektrike e pajisjes efiente në treg në funksionin aktiv	w	
Fuqia elektrike e pajisjes në funksionin pasiv	w	
Fuqia elektrike e pajisjes efiente në treg në funksionin pasiv	w	
Fuqia e pajisjes në funksionin aktiv, pas modifikimit të pajisjes ekzistuese	w	
Fuqia elektrike në funksionin pasiv, pas modifikimit të pajisjes ekzistuese	w	
Numri i orëve në funksionin aktiv	h/vit	
Numri i orëve në funksionin pasiv	h/vit	

ë) Impiante fotovoltaike

Emërtimi	Njësia	Vlera
Fuqia pik e instaluar e sistemit PV	kw _{peak}	
Kohëzgjatja e rrezatimit diellor e 1000 w/m ² (ngarkesa e plotë)	h/a	
Shkalla e performancës së impiantit PV; raporti midis energjisë aktuale të prodhuar me atë teorike nga impianti PV	%	
Pjesa e energjisë elektrike që futet në rrjetin publik dhe nuk mund të vlerësohet si reduktim i energjisë së shitur	%	
Fuqia specifike e modulit PV	kw _{peak} /m ²	
Shuma mesatare e rrezatimit diellor për njësi të sipërfaqes së përfutur nga modulet PV të një sistemi të caktuar me një kënd pjerrësie të caktuar (psh.35°) dhe kënd të azimuthit	kwh/m ²	
Eficienca elektrike mesatare e moduleve PV	%	



Humbjet e sistemit të kombinuar PV [%] - Humbjet e llogaritura në saje të temperaturës dhe rrezatimit të ulët; 8.1% (duke përdorur temperaturën e mjedisit) - humbjet e llogaritura në saje të efekteve këndore të reflektimit: 2.9%; - Humbje të tjera (kablo, inverter etj.)	%	
--	---	--

F) Impiante termike diellore

Emërtimi	Njësia	Vlera
Sipërfaqja e instaluar e kolektorëve diellorë	m ²	
Nxehhtësia mesatare vjetore e gjeneruar për njësi të sipërfaqes së kolektorit	kwh/m ² .vit	
Faktori i shfrytëzimit për sistemin aktual të ngrohjes	%	
Eficienca e shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes	%	

Sistemi aktual i ngrohjes me elektricitet ose lëndë djegëse gaz, naftë, biomasë etj.	lloji	
--	-------	--

SHTOJCA II

INFORMACIONI I NEVOJSHËM PËR INVENTARIZIMIN E NDËRTESAVE PUBLIKE

Nr.	Emërtimi
1	Emri i ndërtesës/adresa – Emri i ndërtesës dhe adresa e vendndodhjes së saj
2	Koordinatat sipas formatit KRRGJSH-së – Koordinatat e vendndodhjes së ndërtesës të gjendura përmes ASIG Geoportal
3	Bashkia – Bashkia në territorin e së cilës ndodhet ndërtesa
4	Funksioni për të cilin përdoret ndërtesa – Funksioni për të cilën është në përdorim ndërtesa (shkollë, spital...)
5	Numri maksimal i punonjësve në ndërtesë
6	Indeksi i hartës – Indeksi i hartës, identifikuar përmes ASIG Geoportal
7	Numri i pasurisë – Numri i pasurisë, identifikuar përmes ASIG Geoportal
8	Sipërfaqja e gjurmës – Sipërfaqja e gjurmës së ndërtesës në m ²
9	Sipërfaqja totale e kateve të ndërtesës [m²] - Sipërfaqja totale e secilit kat të ndërtesës, që është i izoluar nga ambienti i jashtëm m ²
10	Numri i kateve – Numri i kateve të ndërtesës
11	Vëllimi [m³] – Vëllimi m ³
12	Viti i ndërtimit – Viti në të cilin ndërtesa ka përfunduar së ndërtuari
13	Rikonstruktuar – Po – nëse ndërtesa është rikonstruktuar ndonjëherë dhe në cilin vit /Jo – nëse ndërtesa nuk i është nënshtruar ndonjëherë rikonstruksionit
14	Izolim termik (mm) – Shënoni nëse ndërtesa ka izolim termik apo jo. Nëse njihet lloji i termoizolimit dhe trashësia e tij të shënohet.
15	Tipologjia e dritareve – Lloji i dritareve nëse janë dopio xham apo me një xham.
16	Tipologjia e sistemit të ngrohje/ftohjes – Tipologjia e sistemit të ngrohje/ftohjes (split, multisplit, kaldajë)
17	Konsumi vjetor i energjisë për vitin paraardhës (vendos vitin) – Konsumi i energjisë për vitin _____ në varësi të bartësve të energjisë
18	Konsumi vjetor i energjisë për vitin e dytë paraardhës (vendos vitin) – Konsumi i energjisë për vitin _____ në varësi të bartësve të energjisë
19	Konsumi vjetor i energjisë për vitin e tretë paraardhës (vendos vitin) – Konsumi i energjisë për vitin _____ në varësi të bartësve të energjisë
20	Numri i kontratës me OSHEE-në – Numri i kontratës së lidhjes me FSHU-në (furnizuesin e shërbimit universal) OSHEE
21	Institucioni me përgjegjësi administrative – Institucioni me përgjegjësi administrative (p.sh. Ministria e Shëndetësisë)
22	Enti përdorues, statusi juridik – Enti përdorues statusi juridik (p.sh. Drejtoria e Shëndetit Publik Berat)

SHTOJCA III

GRADE DITËT E NGROHJES

Nr.	Qyteti	Pragu	
		17.5 °C	
		Gr. ditë	Nr. i ditëve
1.	Ballsh	1535	216
2.	B. Curri	2594	228
3.	Berat	1536	213
4.	Bilisht	2878	265
5.	Burrel	2012	232
6.	Cërrik	1607	205



7.	Çorovodë	1748	223
8.	Durrës	1244	204
9.	Elbasan	1537	215
10.	Ersekë	2897	271
11.	Fier	1473	215
12.	Gjirokastër	1773	221
13.	Gramsh	1661	218
14.	Himarë	997	190
15.	Kavajë	1541	219
16.	Konispol	1507	218
17.	Koplik	1721	213
18.	Korçë	2774	260
19.	Krujë	1842	232
20.	Krumë	2605	245
21.	Kuçovë	1425	208
22.	Kukës	2462	238
23.	Lezhë	1451	211
24.	Librazhd	1990	226
25.	Lushnjë	1287	202
26.	Laç	1538	209
27.	Përmet	1752	218
28.	Peshkopi	2698	249
29.	Pogradec	2450	251
30.	Pukë	2896	262
31.	Rrëshen	1988	225
32.	Sarandë	930	182
33.	Shkodër	1692	215
34.	Tepelenë	1580	214
35.	Tiranë	1534	214
36.	Vlorë	1169	200

SHTOJCA IV METODOLOGJIA PËR PIKËZIMIN DHE KUALIFIKIMIN E NDËRTESAVE

Kriteret	Pikët
1.Ndërtesa pa termoizolim, me dritare me një xham dhe pa sistem qendror ngrohje/ftohje	20
2.Ndërtesa pa termoizolim, me dritare me një xham dhe me sistem qendror ngrohje/ftohje	10
3.Ndërtesa pa termoizolim, me dritare me dopio xham dhe pa sistem qendror ngrohje/ftohje	15
4.Ndërtesa pa termoizolim, me dritare me dopio xham dhe me sistem qendror ngrohje/ftohje	5
5.Ndërtesa me termoizolim, me dritare me dopio xham dhe pa sistem qendror ngrohje/ftohje	15
6.Numri maksimal i punonjësve për çdo ndërtesë sipas strukturës organizative të institucionit dhe sipërfaqes së dobishme:	
a)0 – 2.5 m ² për punonjës	30
b)2.51 – 5 m ² për punonjës	20
c)5.01 – 7.5 m ² për punonjës	12
ç) 7.51 – 10 m ² për punonjës	5
d)Mbi 10 m ² për punonjës	2
7.Ndërtesat me performancë energjetike më të ulët:	
a)me konsum energjie më të madh se 150 kwh/m ² /vit dhe më të vogël se 225 kwh/m ² /vit, verifikuar përmes faturave të bartësve të energjisë	15
b)me konsum energjie më të madh se 226 kwh/m ² /vit dhe më të vogël se 299 kwh/m ² /vit, verifikuar përmes faturave të bartësve të energjisë	22
c)me konsum energjie më të madh se 300 kwh/m ² /vit, verifikuar përmes faturave të bartësve të energjisë	30
8.Ndërtesa që shfrytëzohen nga fëmijë (<18 vjeç) dhe të moshuar (>65 vjeç)	20
9.Pozicioni gjeografik i ndërtesës dhe kushtet atmosferike përkatëse (për renditjen do të përdoren gradë – ditën e ngrohjes sipas shtojcës III, ku përparësi do të kenë ndërtesat që ndodhen në qytetet/zonat, ku gradë-ditët e ngrohjes janë më të mëdha)	Gradë – Ditë 100
10.Lloji i bartësit energjetik aktual, duke synuar mënjanimin e përdorimit të burimeve energjetike me përmbajtje fosile:	
a)bartës energjetik fosil;	10
b)bartës energjetik i rinovueshëm.	1

**VENDIM****Nr. 469, datë 17.7.2024****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
LINJËS 110 kV ELBASAN 1 – CËRRIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë, 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Elbasan 1 – Cërrik”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “ullishte”, me një vlerë të përgjithshme prej 440 484 (katërqind e dyzet mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 440 484 (katërqind e dyzet mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhen këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë të pasurive që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

Nr. rendor	Nr. shyllje	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SI PAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME			ADRESA
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Aet (m²)	T.nall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Ae						VLERA TOTALE (lek)	Nr. doka	Data e regjistrimit	Seksionet D & E të kartelës së pasurisë	
															Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek./m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek./m²)	Vlera (lek)					
1	1	Dalip	Beqir	Tafa	Bradashesh	1258	70/1	Arc	1931	1931					151	222	33522			33,522				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
		Alpin	Dalip	Tafa																					
		Ismail	Dalip	Tafa																					
		Artana	Dalip	Kurti/Tafa																					
		Ramonda	Dalip	Gela/Tafa																					
2	2	Hajme	Hasan	Tufa	Bradashesh	1258	82/6	Arc	1100	1100					107	222	23754			23,754	003177	03.09.2019	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar me nr. 82/612-ND, V.10, F.65, në pronësi të Lin Tanushi. Ndërtesa nuk preket nga shpronësimi.	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan	
		Sulejman	Avdi	Tufa																					
		Fatmir	Avdi	Tufa																					
		Beqir	Avdi	Tufa																					
		Liri	Avdi	Tamusha																					
		Etleva	Avdi	Kasa/Tufa																					
		Nuri	Ismail	Gela																					
		Enzon	Nuri	Gela																					
		Dhoni	Nuri	Gela																					
3	2	Sabri	Ahmet	Mullahu	Bradashesh	1258	82/7	Arc	1600	1600					8	222	1776			1,776				Konfirmuar nga ASHK-ja-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
4	3	Zenel	Mustafa	Skenden	Bradashesh	1258	82/10	Arc	1500	1500					14	222	3108			3,108				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
5	3	Kaçim	Mustafa	Skenden	Bradashesh	1258	82/11/1	Arc	900	900					24	222	5328			5,328				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
6	4	Avni	Zyber	Skenden	Bradashesh	1258	86/3	Arc	600	600					56	222	12432			12,432				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
7	4	Bajram	Ymer	Skenden	Bradashesh	1258	86/4	Arc	836	836					14	222	3108			3,108				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
8	5	Hijmet	Nazim	Gela	Bradashesh	1258	115/24/1	Arc	2310	2310					58	222	12876			12,876				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
9	6	Mustafa	Bashe	Zavalina	Bradashesh	1258	115/9	Arc	1400	1400					20	222	4440			4,440				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
10	13	Ism	Met	Zavalina	Bradashesh	1258	1/32	Ullishte	13070						70	222	15540			15,540				Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri nuk ka të mbijella dhe vlerësimi është bërë si tokë bujqësore	Fshati Bradashesh/NJA Bradashesh/Bashkia Elbasan
		Gani	Islam	Zavalina																					
		Gazmir	Ahmet	Zavalina																					
		Hysni	Ibrahim	Ibrahim																					
		Ahmet	Hysni	Ibrahim																					
		Fadil	Shahin	Ibrahim																					
		Skënder	Ahmet	Ibrahim																					
		Selim	Osmari	Gani																					
		Osmari	Ibrahim	Gani																					
		Riza	Xhemal	Gani																					
		Bajram	Riza	Gani																					
		Artan	Dhimitër	Parxhi																					
		Gori	Josif	Parxhi																					
		Sani		Parxhi																					
		Josif	Gori	Parxhi																					
		Mari	Gori	Parxhi																					
		Fadil	Beqir	Zavalina																					
		Sani	Fadil	Zavalina																					
		Ali	Ismail	Gela																					
		Riza	Ismail	Gela																					
		Riuferr	Gela																						
		Riza	Kaloni	Zavalina																					
		Ali	Kaloni	Zavalina																					
		Namuk	Ali	Agothi																					
		Kaçim	Ramazan	Mullahu																					
11	14	Ali	Ramazan	Mullahu	Balldre	1085	109/29	Ullishte	3000						58	222	12876			12,876				Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri nuk ka të mbijella dhe vlerësimi është bërë si tokë bujqësore	Fshati Balldre/NJA Papër/Bashkia Elbasan
		Brenda	Mevlan	Kasa																					
		Elida	Mevlan	Kasa																					
		Klement	Mevlan	Kasa																					
		Loreta	Mevlan	Kasa																					
		Oljori	Mevlan	Kasa																					
		Rodina	Mevlan	Kasa																					
		Shpresa	Mevlan	Kasa																					
		Mevlan	Ali	Kasa																					
12	17	Ylli	Hamza	Luli	Balldre	1085	177/7	Ullishte	720						5	222	1110			1,110				Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri nuk ka të mbijella dhe vlerësimi është bërë si tokë bujqësore	Fshati Balldre/NJA Papër/Bashkia Elbasan
		Bora	Ylli	Luli																					
		Manushaqe	Shenit	Luli																					
13	17	Faton	Qerim	Veshi	Balldre	1085	217/57	Ullishte	720						65	222	14430			14,430				Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri nuk ka të mbijella dhe vlerësimi është bërë si tokë bujqësore	Fshati Balldre/NJA Papër/Bashkia Elbasan
		Qerim	Maliq	Veshi																					
		Saime	Shenit	Veshi																					
14	19	Xhafer	Isuf	Xhaka	Vidhas	3764	14/34	Arc+ Truall	3173						41	222	9102			9,102				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
15	20	Xhafer	Isuf	Xhaka	Vidhas	3764	14/33	Arc+ Truall	2564						70	222	15540			15,540				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
16	22	Vith	Mehmet	Xhaka	Vidhas	3764	36/8	Arc	1255	1255					21	222	4662			4,662				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
17	22	Ferit	Avdi	Xhaka	Vidhas	3764	36/9	Arc	3660	3660					37	222	8214			8,214				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
18	23	Ridmari	Rifat	Shogrnaka	Vidhas	3764	39/2/1	Arc	1800	1800					34	222	7548			7,548				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
19	23	Xhemal	Rifat	Shogrnaka	Vidhas	3764	39/2/2	Arc	4550	4550					24	222	5328			5,328				Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan



20	24	Reshit	Demir	Haka	Vidhas	3764	57/9	Are	12450	12450					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
21	25	Furur	Gani	Marrachiu	Vidhas	3764	56/3	Are	9748	9748					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
22	26	Frank	Kova		Vidhas	3764	90/1	Are	15318	15318					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
23	27	Xhevdet	Islam	Sina	Vidhas	3764	99/5/4	Are	2856	2856					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
24	28	Petit	Beqir	Bahja	Vidhas	3764	99/14	Are	7280	7280					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
25	29	Latif	Nezir	Lali	Vidhas	3764	102/6	Are	3350	3350					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
26	30	Sharif	Hasan	Hasa	Vidhas	3764	136/12	Are	3927	3927					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
27	31	Ymer	Ali	Hasa	Vidhas	3764	137/9	Are	5174	5174					20	222	4440							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
28	31	Qerem	Salezman	Gjeli	Vidhas	3764	137/10	Are	4025	4025					38	222	8436							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
29	32	Adile	Rexhep	Tusha	Vidhas	3764	317/4/1	Are	8000	8000					151	222	33522							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
	32	Nexhip	Qerem	Tusha																					
	32	Shpresa	Krapush	Tusha																					
	32	Xhevit	Nexhip	Tusha																					
	32	Naim	Xhevit	Tusha																					
30	33	Arlian	Aqif	Pepa	Vidhas	3764	324/8	Are	7280	7280					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
31	34	Xhemali	Zenel	Gepa	Vidhas	3764	325/19	Are	10654	10654					58	222	12876							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Vidhas/NJA Papër/Bashkia Elbasan
		Hasbi	Shefqet	Gela																					
32	39	Agron	Hashi	Gela	Cernik- Ferme	2281	263/4	Are	3000						182	222	40404							Konfirmuar nga ASHK-ja	Fshati Cernik- Ferme, NJA: Cernik, Bashkia: Cernik
33	18/2/2	GSA			Balldre	1085	4/19	Truall	100615		100615				151		151	234	35334	35,334				Konfirmuar nga ASHK-ja Origjina e pasurisë: regji- hipotekar nr. 42-49, datë 8.11.2016	Fshati Balldre/NJA Papër/Bashkia Elbasan
34	2/1	Arlian	Misir	Jahja	Balldre	1085	177/12	Ullishte	1920						35	222	7770							Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri nuk ka të mbylla dhe vlerësimi është bërë si tokë bujqësore	Fshati Balldre/NJA Papër/Bashkia Elbasan
		Artur	Misir	Jahja																					
		Damiano	Misir	Jahja																					
		Ela	Misir	Jahja																					
		Misir	Hyson	Jahja																					
		Natije	Mustafa	Jahja																					
		Valbona	Misir	Jahja																					
VLERA TOTALE															1976		151		440,484						



VENDIM

Nr. 470, datë 17.7.2024

**PËR PEZULLIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS BASHKËPUNUESE TË
GUAJANËS, PËR PËRJASHTIMIN NGA
KËRKESAT PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE,
PASAPORTAVE TË SHËRBIMIT DHE
PASAPORTAVE TË ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pezullimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës, për përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme, miratuar me vendimin nr. 190, datë 4.3.2020, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 472, datë 17.7.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT
‘PËR AKCIZAT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 54, pika 5, 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit ‘Për akcizat’”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 50/1 ndryshon në titull dhe në përmbajtje, si më poshtë vijon:

“Neni 50/1

**Statusi i personave të autorizuar për
veprimtarinë e pullave fiskale**

Për qëllime të neneve 40–43, të seksionit 8, të kreut V, të ligjit, personi juridik publik i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale duhet të marrë statusin e depozituesit të miratuar prodhues.”.

Neni 2

Pika 2, e nenit 102, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. “Shënjes” është një substancë apo element, prezenca e së cilës/të cilit, në përgjithësi, nuk është e dukshme, por zbulohet me anë të reaksionit kimik, biologjik ose të proceseve teknologjike.”.

Neni 3

Pas nenit 102 shtohet neni 102/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 102/1

**Procedurat për ngjyrimin/shënjimin për
nënproduktet e naftës me përjashtim apo
reduktim nga akciza**

Nënproduktet, të cilat përfitojnë përjashtim apo reduktim nga pagesa e akcizës ngjyrosen dhe/ose shënjohen sipas procedurës së përcaktuar në nenet 103–109, të këtij vendimi.”.

Neni 4

Pas nenit 109 shtohen nenet 109/1 dhe 109/2, me këtë përmbajtje:



“Neni 109/1

Shënjimi/ngjyrimi i produkteve energjetike, që i nënshtrohen pagesës së akcizës

1. Për qëllim të ushtrimit të kontrollit nga administrata doganore, produktet, të cilat kanë detyrim pagimin e akcizës, mund të shënjohen/të ngjyrosen. Produktet e shënjimit janë produktet e bardha (gazoil dhe benzen), produktet e zeza (solar dhe mazut), lëndët djegëse dhe produktet e ndërmjetme, specifikisht produktet me emërtimet dhe klasifikimin tarifor të NKM,-së si vijon: gazoil (27101943, 27101946 dhe 29101948), benzinë pa plumb (27101241, 27101245 dhe 27101249), solar/mazut (27101962, 27101964, 27101968). Administrata doganore është përgjegjëse për administrimin e procesit të shënjimit/ngjyrimit.

2. Substancat, që përdoren si shënjes/ngjyruar për qëllime kontrolli, njihen si të përshtatshme nga një komision i posaçëm, ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, përpara përdorimit të tyre për herë të parë në territorin kombëtar. Këto substanca importohen vetëm nga administrata doganore.

3. Procesi i shënjimit/ngjyrimit realizohet përpara kryerjes së pagesës së akcizës dhe shoqërohet me një dokument, që vërteton kryerjen e shënjimit/ngjyrosjes.

4. Mbikëqyrja dhe kontrolli është procesi që kryhet nga administrata doganore me anë të teknologjisë së posaçme në dispozicion të saj, nëse këto produkte janë shënuar/ngjyrosur.

5. Asnjë nga produktet e akcizës, për të cilat është i detyrueshëm shënjimi/ngjyrimi, nuk mund të hidhet për konsum/qarkullim të lirë i pashënuar/i pangjyrosur.

Neni 109/2

Porositja dhe kryerja e shërbimit të shënjimit/ngjyrimit

1. Procesi i shënjimit/ngjyrimit kërkohet nga subjektet dhe realizohet përpara kryerjes së pagesës së detyrimeve të akcizës për produktet e shënjimit/ngjyrimin në zotërim të subjekteve të detyruara.

2. Kërkesa duhet të specifikojë:

a) identitetin e subjektit, që kërkon kryerjen e shërbimit të shënjimit;

b) veprimtarinë tregtare të zhvilluar nga subjekti zotërues i produktit të shënjimit;

c) llojin e produktit;
ç) vëllimin e produktit;
d) vendndodhjen e produktit dhe mënyrën e ruajtjes së tij.

3. Kërkesat e marra regjistrohen në regjistrin e posaçëm të porosive. Në përfundim të shënjimit/ngjyrimin, subjekti pajiset me dokumentin përkatës, që vërteton kryerjen e shënjimit/ngjyrimin.

4. Procedura më të hollësishme për administrimin e procesit të shënjimit/ngjyrimin, si dhe mbikëqyrjen e kontrollin e tij përcaktohen me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare.”.

Neni 5

Vendimi nr. 498, datë 30.5.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 6

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 9.8.2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM
Nr. 473, datë 17.7.2024****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 192, DATË 27.3.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT ‘PËR ZBATIMIN E MËNYRAVE ALTERNATIVE TË PAGESËS SË SHPEJTË’ DHE TË PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E TIJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronja “ç”, dhe 9/1, të ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 192, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e projektit pilot ‘Për zbatimin e mënyrave alternative të pagesës së shpejtë’ dhe të procedurave për zbatimin e tij”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalja e tretë riformulohet, si më poshtë vijon:

“Vlera monetare disbursohet nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e *Startup*-ve dhe Lehtësuesve (“*Startup Albania*”) në formën e një transferte bankare, brenda datës 30 të çdo muaji, në periudhën kohore korrik deri në tetor 2024, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve (“*Startup Albania*”) dhe bashkitë, në të cilat do të zbatohet projekti, lidhin një marrëveshje për mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve të bashkitë përkatëse. Përzgjedhja duhet të jetë e tillë që të garantojë përbërje të drejtë midis moshës, që përfshin përkatësisht përfitues nga grupmoshat 18–30 vjeç, 30–40 vjeç, 40–50 vjeç, 50–60 vjeç, si dhe 60–70 vjeç, dhe gjinisë së tyre, që banojnë brenda një hapësire gjeografike të afërt brenda territorit të bashkive Tiranë, Dibër e Përmet. Bashkitë përzgjedhin përfituesit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas lidhjes së marrëveshjes. Numri i përfituesve për secilën bashki është 100. Lista emërore me të dhënat e përfituesve për çdo bashki dërgohet pranë Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve (“*Startup Albania*”).”

3. Në pikën 12, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile” zëvendësohet me fjalët “... bashkitë Tiranë (Njësia Administrative 5), Dibër e Përmet ...”.

4. Në aneksin A, në paragrafin e dytë të deklaratës, fjalët “..., për periudhën maj, qershor, korrik dhe gusht 2024 ...” zëvendësohen me “..., për periudhën korrik, gusht, shtator, tetor 2024 ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 474, datë 17.7.2024

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Vangjel Tavo, prefekt i qarkut të Vlorës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 1, datë 17.7.2024

**PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
MBAJTJES SË REGJISTRIT TË LEJES SË
NDËRTIMIT, SI DHE TË
PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT TË
KONTRATËS SË SIPËRMARRJES/
POROSISË DHE TË PREMTIMSHITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, pika 3, e 50, pika 7, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e:

a) modelit dhe të rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit;

b) rregullave të regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes/porosisë dhe të premtimshitjes të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, me pronarin e truallit dhe blerësin/porositësin.

2. Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



a) **“Karabina”**, objekti sipas përkufizimit të bërë në pikën 7, të nenit 3, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;

b) **“Leje ndërtimi”**, akti administrativ i përkufizuar në pikën 16, të nenit 3, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar;

c) **“Ligj”**, ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar;

ç) **“Regjistër i lejes së ndërtimit”**, regjistri i posaçëm publik, digjital dhe manual, ku regjistrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit dhe kontrata e sipërmarrjes, porosisë apo premtimshitjes të lidhura ndërmjet investitorit me pronarin e truallit dhe me blerësin/porositësin.

II. MODELI DHE MËNYRA E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË LEJES SË NDËRTIMIT

1. Modeli i regjistrit të lejes së ndërtimit është sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Regjistri i lejes së ndërtimit plotësohet e administrohet në format digjital dhe, për këto të dhëna, ASHK-ja lëshon vërtetimin e regjistrimit të lejes së ndërtimit, pas paraqitjes së kërkesës nga subjekti i interesuar, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.

3. Nga ASHK-ja kryhen veprime me regjistrin e lejes së ndërtimit, deri në momentin që regjistrohet karabinaja sipas nenit 49, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe që aktet noteriale të sipërmarrjes/porosisë/premtimshitjes transferohen nga regjistri i lejes së ndërtimit te regjistri i karabinasë.

4. Të dhënat e ruajtura në regjistrin e lejes së ndërtimit/zhvillimit aksesohen e përpunohen në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atë për të drejtën e informimit.

5. Kryetari i bashkisë ose Këshilli Kombëtar i Territorit, sipas rastit, në përputhje me përcaktimet e nenit 48, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe me këtë udhëzim, përcjell, për regjistrim pranë ASHK-së, lejen e ndërtimit dhe dokumentacionin shoqërues. Autoriteti që lëshon lejen e ndërtimit e përcjell dokumentacionin e lejes së ndërtimit në format elektronik, si edhe nëpërmjet shërbimit postar.

6. ASHK-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përcjelljes nga kryetari i bashkisë ose Këshilli Kombëtar i Territorit, sipas rastit, regjistron në kartelën e pasurisë së paluajtshme “truall”, për të cilën është lëshuar leja e ndërtimit, të dhënat e lejes së ndërtimit, në seksionin B/1 “Të dhënat e regjistrimit paraprak”.

7. Regjistri i lejes së ndërtimit, për lejen përkatëse, plotësohet nga ASHK-ja vetëm pasi subjekti i interesuar të paraqesë kërkesën për shërbimin “Regjistrimi i lejes së ndërtimit”, në përputhje me procedurat dhe afatet e vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.

III. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË KONTRATËS SË SIPËRMARRJES, POROSISË DHE PREMTIMSHITJES

1. Në regjistrin e lejes së ndërtimit regjistrohen dhe aktet noteriale të sipërmarrjes, të porosisë dhe të premtimshitjes, të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, pronarit të truallit dhe blerësit/porositësit të njësisë individuale, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 50, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe në këtë udhëzim.

2. Regjistrimi i akteve noteriale, të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, bëhet pas paraqitjes së kërkesës së subjektit të interesuar për shërbimin kadastral me numër 35, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.

3. Regjistrimi sipas pikave 1 e 2, të këtij kreu, qoftë në regjistrin kadastral apo atë të lejes së ndërtimit, kryhet nga ASHK-ja pasi verifikohen kushtet e mëposhtme:

a) elementet formale të aktit noterial janë në përputhje me legjislacionin për noterinë;

b) akti noterial ndërmjet zhvilluesit dhe pronarit të tokës përmban të dhëna të plota (numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe, kufij, pozicion gjeografik) për evidentimin e pasurisë, të cilat përputhen me të dhënat e pasqyruara në regjistrin kadastral;

c) të dhënat në përmbajtje të aktit për njësitë janë të individualizuara sipas planimetrive, të miratuara me lejen e ndërtimit;

ç) nëse ka akte noteriale të regjistruara më parë për zhvillimin e pronës në regjistrin kadastral;



d) nëse ka akte noteriale, kontrata sipërmarrjeje/porosie/premtimshitjeje të regjistruara më parë, të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe një subjekti tjetër në regjistrin e lejes së ndërtimit.

4. Për aktet noteriale të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, dhe pronarit të truallit, që synojnë në të ardhmen zhvillimin e pronës dhe kalimin e pronësisë mbi ndërtimin, verifikohet edhe ekzistenca në akt e kushtit apo e afatit për realizimin e së drejtës së zhvillimit.

5. Kur rezulton se plotësohen kushtet e parashikuara në pikat 3 e 4, të këtij kreu, ASHK-ja vepron, si më poshtë vijon:

a) regjistron aktin noterial të lidhur ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarit të truallit, në seksionin “D”, të kartelës kadastrale, të pasurisë “truall”;

b) pas regjistrimit të lejes së ndërtimit për këtë pasuri “truall”, ASHK-ja pasqyron kryesisht të dhënat e aktit noterial të lidhur ndërmjet zhvilluesit dhe pronarit të tokës, edhe në regjistrin e lejes së ndërtimit. Nëse palët kanë lidhur një akt të ri noterial, të ndryshëm nga ai i regjistruar sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, subjekti duhet të paraqesë kërkesën sipas pikës 2, të këtij kreu, për regjistrimin e tij;

c) regjistron në regjistrin e lejes së ndërtimit, te të dhënat e akteve juridike paraprake, aktin noterial të sipërmarrjes/porosisë/premtimshitjes të lidhur ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe blerësit/porositësit të njësisë individuale.

6. Kur gjatë shqyrtimit të kërkesës për regjistrim rezulton se aktet noteriale të lidhura ndërmjet pronarit të truallit dhe zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, apo blerësve/porositësve kanë të meta në elementet e kërkuara, sipas pikës 3, të këtij kreu, ato i njoftohen kërkuarës, duke i lënë 30 (tridhjetë) ditë afat për plotësimin e tyre. Njoftimi për plotësimin e të metave është sipas formularit të miratuar me vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, të ndryshuar. Nëse pas kalimit të afatit këto të meta nuk plotësohen, nga ASHK-ja refuzohet regjistrimi i aktit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

7. Kur akti noterial i regjistruar në regjistrin kadastral, lidhur ndërmjet zhvilluesit, në cilësinë e investitorit, dhe pronarit të truallit, ka si kusht për

zhvillimin miratimin e lejes së ndërtimit brenda një afati të caktuar dhe ky kusht nuk është realizuar, ASHK-ja bën ndryshimet në seksionin D, të kartelës së pasurisë së paluajtshme “truall” lidhur me aktin noterial të regjistruar. Këto ndryshime bëhen me kërkesë noteriale të njëres nga palët, pasi kjo e fundit të depozitojë dokumentacionin që provon mospërmbushjen e kushtit, brenda afatit të përcaktuar në aktin noterial. Këtu bën përjashtim rasti kur palët në aktin noterial kanë vendosur që, për mosmarrëveshjet lidhur me kushtin, do t’i drejtohen gjykatës.

8. ASHK-ja, në momentin kur kryhet regjistrimi përfundimtar i ndërtimit të ri, sipas nenit 51, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, pasqyron:

a) kontratën e sipërmarrjes/porosisë të lidhur ndërmjet zhvilluesit, me cilësinë e investitorit, dhe pronarit të tokës, në seksionin D të kartelës së pasurisë të paluajtshme të regjistruara në pronësi të investitorit. Pas realizimit të kontratës së shkëmbimit ndërmjet palëve bëhet regjistrimi në regjistrin kadastral, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”;

b) kontratën e sipërmarrjes/porosisë dhe premtimshitjes të lidhur ndërmjet zhvilluesit, me cilësinë e investitorit, dhe blerësve/porositësve të njësisë individuale, në seksionin D, të kartelës së pasurisë të paluajtshme të regjistruara në pronësi të investitorit. Pas realizimit të kontratës së shitjes ndërmjet investitorit dhe blerësit/porositësit të njësisë individuale bëhet regjistrimi në regjistrin kadastral, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Kur në regjistrin kadastral, në kartelën e pasurisë “truall”, rezultojnë të regjistruara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi akte noteriale ndërmjet pronarit të truallit dhe zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, në të cilët nuk është individualizuar pasuria që do të përfitojë pronari i truallit, ASHK-ja në momentin e paraqitjes për regjistrim në regjistrin e lejes të kontratave të sipërmarrjes/porosisë apo premtimshitjes ndërmjet investitorit me pronarin e truallit apo me të tretë, verifikon nëse të dhënat mbi njësitë në këto akte janë të individualizuara sipas planimetrive, që i bashkëlidhen lejes së ndërtimit. Në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, regjistrimi i tyre refuzohet.



2. Lejet e ndërtimit të regjistruara në regjistrat manualë përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për të cilat nuk është vijuar me regjistrimin e karabinasë apo regjistrimin përfundimtar të ndërtimit të ri, pasqyrohen edhe në regjistrin digital të lejes së ndërtimit, të krijuar sipas këtij udhëzimi.

3. Aktet noteriale, kontratë sipërmarrjeje/porosie/premtimshitjeje të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, dhe të blerësve/porositësve, regjistrohen pas regjistrimit të lejes së ndërtimit në regjistrin e lejes.

4. Udhëzimi nr. 1, datë 13.4.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e kritereve e të

procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin, në cilësinë e investitorit, e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njëjësive individuale, të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

[illegible]

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 31948/13
Lulzim Caka kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 21 maj 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekrete e Seksionit*, duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 31948/13) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 6

shkurt 2013 nga një shtetas shqiptar, z. Lulzim Caka (“kërkuesi”), lindur në vitin 1970, i ndaluar në Lezhë dhe i përfaqësuar nga z. B. Rusi, një avokat që e praktikon ligjin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (“Qeveria”) – përfaqësuar nga Agjenti i saj në atë periudhë, znj. E. Muçaj dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit – për ankesat e bëra në mbështetje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave penale ndaj kërkuesit dhe mungesës së një mjeti efektiv në lidhje me këtë të fundit, si edhe për ankesën e bërë në mbështetje të nenit 6 § 3 (d) të Konventës për mosparaqitjen e dëshmitarëve, dëshmitë e të cilëve u përdorën si prova për dënimin e kërkuesit dhe për të shpallur si të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHITES

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për padrejtësi në procedurat penale ndaj kërkuarit për



pamundësinë e tij për të pyetur tre dëshmitarë të prokurorisë, dëshmitë e të cilëve u përdorën nga gjykata për ta dënuar atë për vrasje të qëllimshme. Kërkuesi u ankua edhe për kohëzgjatjen e procedurave penale dhe mungesën e një mjeti për këtë aspekt.

2. Kjo është kërkesa e dytë që kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës, në lidhje me dënimin e tij për vrasje. Në çështjen *Caka kundër Shqipërisë* (nr. 44023/02, § dhjetor 2009), Gjykata konstatoi shkelje të të drejtave të kërkuesit, sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës. Pas vendimit të Gjykatës në çështjen e mësipërme, kërkuesi kërkoi shqyrtimin e dënimit të tij. Më 7 mars 2012, Gjykata e Lartë e pranoi kërkesën dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë (Gjykata e Apelit).

3. Gjatë rigjykimit, Gjykata e Apelit thirri tre dëshmitarë, B., C. dhe D., sipas udhëzimeve të Gjykatës së Lartë. U konfirmua se dëshmitari C. kishte ndërruar jetë përpara rigjykimit. Gjykata e Apelit i thirri disa herë dy dëshmitarët e tjerë.

4. Në seancën gjyqësore të datës 18 tetor 2012, Drejtoria e Policisë së Fierit informoi Gjykatën e Apelit se nuk mund të garantonte pjesëmarrjen e dëshmitarëve B. dhe D., sepse ata jetonin jashtë vendit, në Greqi dhe Turqi, respektivisht. Prokuroria dhe avokatët e kërkuesve i kërkuan gjykatës që të revokonte vendimin për thirrjen e këtyre dëshmitarëve. As prokuroria dhe as avokatët e kërkuesit nuk paraqitën kërkesë në Gjykatën e Apelit për të thirrur dëshmitarët ose për të marrë dëshmitë e tyre me anë të bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet greke dhe turke.

5. Kërkuesi, me anë të avokatëve të tij, në argumentet e tij përmbyllëse theksoi se ishte i pafajshëm dhe se prokuroria nuk kishte provuar fajësinë e tij. Ai pranoi se Gjykata e Apelit kishte marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar praninë e dëshmitarëve B. dhe D., dhe pranoi se prania e tyre në gjykim ishte objektivisht e pamundur.

6. Më 19 dhjetor 2012, Gjykata e Apelit la në fuqi dënimin e kërkuesit për vrasje. Ajo e mbështeti arsyetimin e saj mbi provat e dhëna në gjykim nga dëshmitari A., mbi deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D. dhënë gjatë hetimit penal, mbi raportin hetimor të skenës së krimit dhe mbi raportin balistik.

7. Kërkuesi apeloj pranë Gjykatës së Lartë me pretendimin se i ishte shkelur e drejta për një gjykim të drejtë. Veçanërisht, ai argumentoi se duke pasur

parasysh mungesën e dëshmitarëve B., C. dhe D. të prokurorisë në gjykim, dëshmitë e tyre paraprake duhej të ishin interpretuar në favorin e tij.

8. Më 28 prill 2015, Gjykata e Lartë e deklaroi apelimin e kërkuesit të papranueshëm, pasi argumentet e tij ishin jashtë fushës së veprimit të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale.

9. Më 6 mars 2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën kushtetuese të kërkuesit, duke arsyetuar se gjykatat më të ulëta kishin vepruar në përputhje me parashikimet ligjore.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Pretendim për shkelje të nenit 6 § 3 (d)

10. Kërkuesi u ankua mbështetur në nenin 6 të Konventës se e drejta e tij për gjykim të drejtë ishte shkelur, pasi ai nuk kishte mundur t'i drejtonte pyetje tre dëshmitarëve të prokurorisë, dëshmitë paraprake të të cilëve ishin përdorur si prova për dënimin e tij.

11. Në parashtrimet e saj, Qeveria argumentoi se njëri prej dëshmitarëve kishte ndërruar jetë përpara gjykimit, për këtë arsye nuk kishte qenë e mundur që ai të thirrej në gjykimin ndaj kërkuesit. Për sa u përket dy dëshmitarëve të tjerë, Qeveria parashtroi se me kërkesën e tij përpara Gjykatës së Apelit për të revokuar vendimin e saj që t'i ftonte ata, kërkuesi kishte rënë dakord që në gjykim të lexoheshin deklaratat që këta dëshmitarë kishin dhënë gjatë hetimit policor. Për këtë arsye, me anë të avokatëve të tij, ishte e qartë se ai kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të pasur të pranishëm dhe për të marrë në pyetje e dëshmitarët B. dhe D.

12. Parimet e përgjithshme në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve në mungesë dhe përdorimi nga gjykata e dëshmive të dhëna nga këta dëshmitarë, duke përbërë në këtë mënyrë një testim trepalësh, janë përmbledhur në çështjen *Schatschaschwili kundër Gjermanisë* ([DHM], nr. 9154/10, §§ 100-31, GJEDNJ 2015) dhe *Al-Khawaja dhe Tabery kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([DHM], nr. 26766/05 dhe 22228/06, §§ 118-47, GJEDNJ 2011). Gjykata thekson veçanërisht se përdorimi si prova i deklaratave të marra në fazën e hetimit policor dhe hetimit gjyqësor në vetvete nuk është kontradiktor me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (d), nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes (shih *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 105).

13. Gjithashtu, Gjykata arsyeton se as germa dhe as fryma e nenit 6 të Konventës nuk e pengojnë një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë, qoftë



shprehimisht apo në heshtje, nga e drejta për garancitë e një gjykimi të drejtë. Megjithatë, nëse një heqje dorë nga një e drejtë e tillë do të duhej të ishte efektive për qëllimet e Konventës, ajo do të duhej të bëhej në mënyrë të qartë, nuk do të duhej të ishte në kundërshtim me ndonjë interes publik të rëndësishëm, dhe do të duhej të ndiqej nga masa mbrojtëse në përpjesëtim me rëndësinë e saj (shih *Dvorski kundër Kroacisë* [DHM], nr. 25703/11, § 100, GJEDNJ 2015, dhe çështjet e cituara në të). Gjithashtu, përpara se të thuhet se një i pandehur, me anë të veprimeve të tij, ka hequr dorë në mënyrë implicite nga një e drejtë e rëndësishme, sipas nenit 6 të Konventës, do të duhet të provohet se ai i ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij në mënyrë të arsyeshme (shih *Hermi kundër Italisë* [DHM], nr. 18114/02, § 74, GJEDNJ 2006-XII dhe *Sejdovic kundër Italisë* [DHM], nr. 56581/00, §§ 87, GJEDNJ 2006-II).

14. Për sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata pranon se dëshmitari C. nuk mund ta ndiqte gjykimin, pasi ai kishte ndërruar jetë. Për sa u përket dëshmitarëve B. dhe D., Gjykata thekson se në seancën gjyqësore të datës 18 tetor 2012, pas informacionit të siguruar nga policia, avokatët mbrojtës të kërkuarit i kërkuan Gjykatës së Apelit ta revokonte urdhrin e saj për t'i thirrur këta dëshmitarë (shih paragrafin 4 më sipër).

15. Gjykata thekson se nuk ka asnjë sugjerim se veprimet e kërkuarit nuk ishin kryer në mënyrë të vullnetshme apo se ishin kryer në kundërshtim me ndonjë interes publik të rëndësishëm. Në gjykatë, kërkuari u përfaqësua nga dy avokatë të zgjedhur prej tij. Asgjë nuk sugjeron se ata nuk kishin dijeni për pasojat e kërkesës së tyre për të revokuar fletëthirrjet e dëshmitarëve. Me anë të avokatëve të tij, kërkuari mund të kishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme se cilat do të ishin pasojat e një sjelljeje të tillë.

16. Gjithashtu, asgjë në legjislacionin e zbatueshëm apo në praktikën gjyqësore nuk e pengonte mbrojtjen të mos dorëzonte mocione për të kërkuar bashkëpunim ndërkombëtar për të siguruar prezencën e atyre dëshmitarëve. Megjithatë, kërkuari dhe avokatët e tij zgjodhën të mos e përdornin atë mundësi. Vëmendje duhet kushtuar edhe ndaj faktit se në asnjë moment gjatë procedurave, si përpara gjykatave vendëse apo përpara Gjykatës, kërkuari nuk ngriti kundërshtime, në lidhje me sjelljen e avokatëve të tij.

17. Konstatimet e mësipërme janë mjaftueshëm për Gjykatën për të arritur në përfundimin se kërkuari hoqi dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje dëshmitarët B. dhe D. Heqja dorë nga ajo e drejtë ishte eksplicite dhe një shprehje e vullnetit të lirë të kërkuarit. Gjykata arsyeton edhe se kërkuari kishte mundësinë të bënte komente ndaj deklarimeve të dëshmitarëve gjatë gjykimit.

18. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se gjykatat vendëse duhej t'i kishin interpretuar në favorin e tij deklaratimet e dhëna nga dëshmitarët B. dhe D. gjatë fazës së hetimeve, duhet të mbahet në konsideratë se në linjë me parimin e subsidiaritetit (varësisë), nuk i takon Gjykatës që të vendosë nëse provat e disponueshme kanë qenë të mjaftueshme për dënimin e një kërkuari, dhe në këtë mënyrë të zëvendësojë vlerësimin e fakteve dhe provave të gjykatave vendëse me vlerësimin e saj. I vetëm shqetësim i Gjykatës është të shqyrtojë nëse procedurat në një çështje të caktuar janë realizuar në mënyrë të drejtë dhe janë në përputhje me Konventën, duke mbajtur në konsideratë edhe rrethanat specifike, natyrën dhe kompleksitetin e çështjes (shih *Taxquet kundër Belgjikës* [DHM], nr. 926/05, § 84, GJEDNJ 2010; *Al-Khawaja dhe Tabery*, cituar më sipër, § 118; dhe *Murtazaliyeva kundër Rusisë* [DHM], nr. 36658/05, § 149, 18 dhjetor 2018).

19. Konsideratat e mësipërme dhe, veçanërisht, fakti se kërkuarit i ishte ofruar mundësia të paraqiste argumentet e tij të mbrojtjes, janë mjaftueshëm për t'i bërë të mundur Gjykatës që të arrijë në përfundimin se duke mbajtur në konsideratë tërësinë e procedurave, ndaj kërkuarit ishte garantuar drejtësia e përgjithshme e procedurave penale.

20. Mbështetur në sa më sipër, kjo ankesë duhet të rrëzohet si qartazi e pambështetur në fakte sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Kohëzgjatja e procedurave dhe një mjet për këtë aspekt

21. Për sa i përket pretendimit për shkelje të kërkesës për “afat të arsyeshëm” në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, parimet e përgjithshme, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave janë përmbledhur në *Frydlender kundër Francës* ([DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

22. Procedurat për të cilat u drejtua ankesa zgjati tre vjet dhe njëmbëdhjetë muaj përpara tri niveleve të juridiksionit.



23. Gjykata konstaton se vonesa nuk mund t'i atribuohet veprimeve të kërkuarit.

24. Për sa i përket veprimeve të gjykatave vendëse, Gjykata arsyeton se ajo nuk ka pasur ndonjë rast që ka zgjatur më shumë se dy vjet dhe një muaj për shpalljen e vendimit. Duke pasur në konsideratë sa më poshtë dhe praktikën e saj gjyqësore në lidhje me këtë çështje (shih, për shembull, *L.Z. kundër Sllovakisë* (vendim), nr. 27753/06, 27 shtator 2011, dhe *Lyszczyńska kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 34863/04, 4 janar 2008), Gjykata gjykon se kohëzgjatja e përgjithshme prej tre vjetësh dhe njëmbëdhjetë muajsh përpara tri niveleve të juridiksionit, nuk tejkalonte çka mund të konsiderohej e arsyeshme në rrethanat konkrete (krahaso *Eckholm kundër Finlandës* (vendim), nr. 5952/03, 10 korrik 2007, dhe *Steiner kundër Austrisë* (vendim), nr. 32637/96, 22 nëntor 2001).

25. Për këtë arsye, Gjykata, gjykon se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 4 të Konventës.

26. Për sa i përket ankesës së bërë në mbështetje të nenit 13, Gjykata gjykon se ajo lidhet në mënyrë të pandashme me çfarë shqyrtohet më sipër dhe për këtë arsye duhet të deklarohet e papranueshme (shih *Ljubičić kundër Kroacisë* (vendim), nr. 17338/05, 10 maj 2007).

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:
E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 13 qershor 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË

LISTA E KËRKESAVE ME ANË TË TË CILAVE PARAQITEN ANKESA, SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS (MOSZBATIMI OSE ZBATIMI I VONUAR I VENDIMEVE VENDËSE)

Nr.	Numri i kërkesës Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së kërkuarit	Shuma e akorduar për dëmin jopasuror për kërkuar (në euro) ¹	Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkuar (në euro) ²
1	37935/18 3.8.2018	Tahir Çuni 1953		Neni 13 – mungesa e mjeteve efektive në ligjin vendës për moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse	15/09/2023	17/08/2023	3,600	-
2	1921/19 7.1.2019	Ilirjan Proko	Gumi Viktor Tiranë		15.9.2023	29.8.2023	3,600	250
3	44307/21 1.12.2021	Durim Grabova 1951			15.9.2023	5.5.2023	1,200	-

¹ Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuarve.

² Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuarve.

**KËRKESË****Nr. 819/9, datë 17.7.2024****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës – Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 192,663,160.28 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e tetë) lekësh.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Hekurudha Shqiptare.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

a) Vlerësimi i pasurive të llojit “arë”, “truall”, “kulturat bujqësore” dhe investime, janë llogaritur bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar; në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 29/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudha Shqiptare–Rehabilitimi i linjës

hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin e Rinasit”, i ndryshuar; në ligjin nr. 52/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat Shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga fondi i përbashkët evropian i Ballkanit Perëndimor”, në bazë të të cilave është hartuar raporti i vlerësimit nga ekspertët e kontraktuar nga Hekurudha Shqiptare dhe miratuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si më poshtë vijon.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Hekurudhës Shqiptare, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 192,663,160.28 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT
Kastriot Gurra

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 19, DATË 17.1.2024, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE Durrës–TERMINALI I TRANSPORTIT PUBLIK TIRANË DHE LIDHJA ME AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)’”

[illegible]

Page | 14568

[illegible]

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 208 lekë